

Junker
Vendi ka bërë
përparim të
madh

Fq.3




**ZAEVI PËR
NDRYSHIMET**
Rikonstruim
dhe zgjerim
të Qeverisë

Fq.5



Titulli
do të jetë
realizim i
një ëndrre
tjetër

Fq.12



Koha

www.koha.mk



**Aktorët që
rënuan
Sirinë**

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3302 · e hënë 26 shkurt, 2018

-1°C | -3°C

15 DEN

EDITORIAL

**Si ta ndih-
mojmë Agim
Nuhiun?**



Titulli i këtij editoriali, që ka formën e pyetjes, zakonisht lansohet kur dikush është në ndonjë hall, dhe personit në fjalë, i bëhet e mundur që përmes solidaritetit publik t'i ndihmohet në tejkalimin e atij halli. Por Agim Nuhiu, zëvendës ministër i Punëve të Brendshme, i Republikës së Maqedonisë, shyqyr nuk ka kurrfarë halli dhe ai gëzon shëndet të plotë. Hallet janë të tjetër kujt kësaj radhe dhe... Fq.2

RAJON

**Arrihet
marrëveshja
për demar-
kacionin** Fq.16

RAJON

**Vrasja e
Ivanoviqit,
Serbinë në
Listën e Zezë
që financojnë
terrorizmin** Fq.16



MINISTRIA E KULTURËS PRANON GABIMET NË PROGRAMIN VJETOR

ELIMINOHEN PROJEKTET E DYSHIMTA



"Dua t'ju informojë se pjesa më e madhe e projekteve të dyshimta tashmë janë tërhequr, për një pjesë presim mendim të Komisionit për Antikorrupsion, ndërsa procedura e ankesave do të japë mundësi që të rregullohen edhe pakënaqësitë tjera", ka thënë ministri Allagjovovski Fq.3

Teprica tek biznesi privat

Shkup, 25 shkurt - Teprica e të punësuarve në administratë prej vitit 2019 do ti ofrohet sektorit privat. Analizat e Shoqatës së menaxherëve të Maqedonisë tregojnë se 30 për qind e të punësuarve në sektorin shtetëror administratën shtetërore janë tepricë, ndërsa nga ana tjetër sektori privat ka nevojë për 80 mijë të punësuar të profileve të ndryshme. Sipas të dhënave të Regjistrimit të administratës të vitit

2016, janë evidentuar 130 mijë nëpunës shtetëror, megjithatë sektori i biznesit vlerëson se së paku 160 mijë persona janë të angazhuar në sektorin shtetëror.

Ideja e qeverisë është që të sigurojë rroga më të larta përmes subvencioneve për ato që do të kalojnë të punojnë nga administrata publike në sektorin privat. Mbështetja financiare shtetërore parashikohet që të jetë... Fq.7



EDITORIAL

SI TA NDIHMOJMË
AGIM NUHIUN?

Emin AZEMI

Titulli i këtij editoriali, që ka formën e pyetjes, zakonisht lansohet kur dikush është në ndonjë hall, dhe personit në fjalë, i bëhet e mundur që përmes solidaritetit publik t'i ndihmohet në tejkalimin e atij halli. Por Agim Nuhiu, zëvendës ministër i Punëve të Brendshme, i Republikës së Maqedonisë, shqyrr nuk ka kurrfarë halli dhe ai gëzon shëndet të plotë. Hallet janë të tjetër kujt kësaj radhe dhe personi i vetëm që mundet t'i shqyrtojë dhe zgjidhë këto halle është pikërisht z. Nuhiu.

Janë disa shqiptarë nga Shkupi e Kumanova që nuk po mundën të vazhdojnë punën në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, edhe pas 20 vjetëve përvojë, për arsye se Ministria e z. Nuhiu nuk po iu jep atyre certifikata sigurie. Kjo i bie që në Qeveri dhe nëpër ministri të ndryshme mund të punojnë shqiptarë, madje të jenë edhe drejtues të rëndësishëm shtetëror, por jo edhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit.

Çka mund të na thotë për këtë Agim Nuhiu, një djalos ambicioz që u shqua në shumë rast se karriera personale e tij nuk vlen më shumë se parimet etike e njerëzore dhe ishte ndër kuadrot e rralla që në momente të ndjeshme pati dijen dhe shkathësinë e menaxhimit të krizave. Mirëpo ai sikur ka nevojë për ndihmë, në radhë të parë nga mediat, me informacione burimore e të sakta, por, gjithsesi, edhe nga vetë të punësuarit në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, të cilët nga dora e parë dhe në mënyrë të drejtpërdrejt do ta njoftonin një epror të lartë të Ministrisë së Brendshme, siç është z. Nuhiu, mbi atë se çka po ndodhë në sektorin e sigurisë në këtë Aeroport, konkretisht në zonën kufitare, ku ka rregulla e masa të posaçme. Ata do ta njoftonin numrin dy të MPB-së për këto standarde të dyfishta që po praktikohen ndaj të punësuarve në këtë aeroport, duke kërkuar sqarime të hollësishme se si është e mundur që një punonjësi aeroport, që rastësisht qëllon të jetë shqiptar, t'i pamundësohet vazhdimi i punës, për arsye se edhe pas 20 viteve përvojë dikujt iu ka tekur ta shpallë atë "non grata".

Në informatat që do t'i shkojnë në ditët në vijim z. Nuhiu do të zbulohen edhe shumë marifetllëqe e padrejtësi që iu janë bërë në vitet e shkuara kuadrove shqiptare në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, duke iu montuar madje atyre edhe incidente, gjoja në formë kontrollësh, vetëm e vetëm për të paraqitur këto kuadro si të padenjë për të ushtruar profesionin e tyre në hapësirat e aeroportit. Të gjitha këto shkelje po ndodhin në një aeroport i cili është porta hyrëse dhe dalje për qindra mijëra pasagjerë nga Maqedonia, rajoni dhe më gjerë. Por, ky aeroport nuk do ta kishte shkallën e lartë të profitabilitetit sikur të mos ishin pasagjerët shqiptarë nga Maqedonia, por edhe nga rajoni, të cilët janë një infuzion i fuqishëm financiar që mban gjallë transportin ajror në këtë vend. A di dikush ta shpjegojë se si është e mundur të ndodhë kjo qasje e dyfishtë ndaj shqiptarëve, në një anë duke i shfrytëzuar resurset e tyre financiare dhe në anën tjetër duke manifestuar shkallë të lartë mosbesimi ndaj atyre që punojnë në aeroport.

Po sikur shqiptarët të organizohen dhe ta bojkotojnë Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit? Çka do të thoshin përgjegjësit e aeroportit nëse një ditë e bukur me diell gdhin pa pasagjerë shqiptarë dhe a do të kërkonin ata nga Ministria e z. Nuhiu të tregohen më konstruktiv ndaj punonjësve në këtë aeroport, sepse nëse vazhdohet me këto praktika diskriminuese pasagjerët shqiptarë shumë shpejt mund t'i drejtohen një aeroport tjetër për vajtje ardhje.

Por, këtë nuk besojmë se do ta lejojë Agim Nuhiu, prandaj ai ka nevojë për ndihmë dhe për kurajo. Ndihma më e madhe që mund t'i jepet atij në këtë moment është të mos inicohet kurrfarë aksioni për bojkotimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit, por të pritret të sqarohen procedurat e largimit të punonjësve shqiptarë dhe urgjentisht të fillohet procedura e kthimit të tyre në punë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të përfitojë ky aeroport, por edhe imazhi i Ministrisë së z. Nuhiu. Pra, vetëm kthimi i drejtësisë në vend për këta punëtorë të larguar dhe braktisja e praktikave të mëtejshme diskriminuese mundet ta shpëtojë Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit nga bojkoti, që ndryshe i bie nga kolapsi.

SIKUR FISHTA TË ISHTE NË TETOVË

"Miku im i dashur! A hiç nuk shikon se si 'fantazisti' i mban leksione realistit dhe intelektualit, a nuk sheh se ky i fundit nuk arrin dot të hapë gojën, a nuk të shohin sytë se si të krisurit ia fusin ashiqare (sy ndër sy) të shastisurit (të trulllosurit). A nuk të shqetëson heshjtja jonë prej varri, a hiç nuk sikletosesh nga ajo sjellja jonë jonormale, karshi jo vlerave të cilët të degdisin në greminë të thellë..., dhe s'di ku tjetër!" Dikur moti, At Gjergj Fishta, i shtyrë nga një 'konflikt politik, kulturor dhe mediatik' me bashkëkohanikët e tij, kishte thurur një shprehje proverbiale, ku pos tjerash thuhet: 'më lehtë mund të mbushësh një thes me pleshta, sesa një grusht me shqiptarë!' Sikur sot Fishta të dukej këtejpari në Tetovë, thënies së tij metaforike, do 'detyrohej' t'i bënte redaktim të ri, dhe do t'i shtonte edhe një thes me pleshta!", shkruan publicisti Fadil Lushi.



TË FORMOHEN OSE JO PARTI POLITIKE

"Kur flasim me miq, shpesh e më shumë se aq, se a është koha të krijojmë një parti të re politike ne që vazhdimisht kritikojmë të deritanishmit... bindja ime është se do varrosnim veten gjithmonë e përjetë me një veprim të këtillë! Vazhdoj të mendoj se është gabuese teza se numërtimi /shumimi në progres i partive politike të shqipëve këtu qenka tregues se po liberalizohet e piqet politikisht shoqëria! Kot tezë është kjo! Ajo çka i mungon skenës është parti e modernizuar, ose parti që donë të modernizohet! Që donë të hapet, të merr frymë, të bëjë ndryshimin brenda vetes e mënyrës së lidërshimit e pjesëmarrjes! Teza ime në bisedën me miq është: jo parti e re, por kyçje e të gjithë atyre që mendojnë se mund të bëjnë një hap ndryshe nëpër partitë ku ka kalibër lidërshimi! Dhe koha kalon shpejt, Samiti i BE ofron shpejt, kontestet në shtet janë ende HAPUR, hmmm, shumë hapur... jemi me shpresë ende! Por përderisa me shpresë rirreshtimet nëpër parti shqipo duhet filluar që tani!", shkruan në profilin e saj në Facebook, publicistja Adelina Marku.



FRIKË NGA REAGIMET PËRRETH

"Për fat të keq, jemi dëshmitarë se shumica e grave ndryshojnë mendim për hir të botës, për hir të asaj se çfarë do të thotë rrethi i saj më i ngushtë. Kjo nuk do duhej të ndodhte asses, por në mungesë të vetëbesimit, në prani të frikës nga reagimet e njerëzve përreth, një grua di të ndryshojë mendim qoftë edhe në dem të saj. Duke e bërë këtë për shkak të dikujt tjetër, një grua vetëm sa e shton pasigurinë e saj dhe e vështirëson daljen nga stereotipat, të cilat tradicionalisht janë prezente në shoqërinë shqiptare", shkruan në profilin e saj në Facebook, shkrimtarja Diana Toska.



MEDIACitate

ASADI
VAZHDON
SULMET, NUK
ENJEH
ARMËPU-
SHIMIN E
KS-OKB

Regjimi i Bashar al-Asadit përkundër vendimit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-OKB) për armëpushim humanitar një muhor në Siri, kryen sulme në Gutën Lindore, Idlib dhe Hama.

Sipas burimeve të Mbrojtjes Civile (Helmetat e Bardha), regjimi i Asadit, përkundër vendimit të mbrëmshëm të KS-OKB-së për "armëpushim humanitar" një muhor në Siri, që nga orët e mëngjesit të ditës së sotme ka sulmuar 8 rajone nga toka dhe ajri. Forcat e regjimit sirian në orët e mëngjesit të ditës së sotme kanë kryer sulme tokësore dhe ajrore ndaj rajoneve Duma, Haresta, Shifoniyye, Kefer Batna, Hammuriye, Sakba, Baeyt Sava dhe Merxh të Gutës Lindore.

Sipas vlerësimeve të para, si pasojë e sulmeve artilerike në qytezën Hammuriye ka humbur jetën një grua. Siç njoftojnë gazetarët në Idlib dhe Hama, forcat e regjimit që nga orët e mëngjesit me gjuajtje artilerike kanë marrë në objektivat zonat civile të qarkut Xhisr esh Shugur të Idlibit, kurse kanë sulmuar nga toka edhe rajonin Kefer Zita të qytetit Hama, në pjesën qendrore të shtetit.

Me projekt-rezolutën e miratuar mbrëmë nga KS-OKB-ja me një votim unanim u vendos për të paktën një muaj armëpushim humanitar për dërgimin e ndihmave humanitare në Siri dhe veçanërisht për evakuimin e njerëzve të sëmurë dhe të plagosur rëndë në Gutën Lindore e cila gjendet nën rrethimin e regjimit. Në vendim kërkohet dërgimi në mënyrë të sigurt, pa pengesë dhe të vazhdueshme i ndihmave humanitare në të gjithë Sirinë dhe ndalimin për të paktën 30 ditë të konflikteve "pa vonesë" nga të gjitha palët për evakuimin e "të sëmurëve dhe të plagosurve rëndë".

(Guardian, 25 shkurt 2018)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KU NDODHET MALI I SHKËLZENIT?

Mali i Shkëlzenit ndodhet në Alpet Shqiptare, në rrethin e Tropojës, me lartësi 2407 m. Shtrihet midis luginës së lumit të Tropojës në verilindje, luginës së lumit të Gashit në jugperëndim dhe pellgut të Tropojës në juglindje. Formon një kurriz të mprehtë midis vetë majës së Shkëlzenit dhe majës së Radeshës. Shpatet

veriperëndimore e juglindore janë mjaft të pjerrëta, kurse shpatet verilindore e jugperëndimore bien thikë mbi luginat. Pjesa kulmore e malit është çarë nga dy lugje akullnajore. Dy majat e tij (Shkëlzeni dhe Radesha) kanë forma tipike piramidale tepër të mprehta. Bimësia mungon thuajse plotësisht.

MINISTRIA E KULTURËS PRANON GABIMET NË PROGRAMIN VJETOR

ELIMINOHEN PROJEKTET E DYSHIMTA



"Dua t'ju informojë se pjesa më e madhe e projekteve të dyshimta tashmë janë tërhequr, për një pjesë presim mendim të Komisionit për Antikorrupsion, ndërsa procedura e ankesave do të japë mundësi që të rregullohen edhe pakënaqësitë tjera", ka thënë ministri Allagjovovski

qësitet tjera. Pas disa vitesh mungesë transparence, i guximshëm ishte vendimi që të publikohen rezultatet, fituesit dhe shumica e mjeteve në një konkurs me 5000 projekte dhe me më shumë se 2500 të pranuar", është shprehur ministri, ndërsa ka shtuar se Prokuroria Publike është ajo që duhet ta thotë fjalën e fundit nëse ka përgjegjësi penale në ndarjen e projekteve. "Koha e keqpërdorimeve në institucione tashmë ka kaluar, ndërsa praktikata e tilla tashmë janë zëvendësuar me praktika të fushës eksperte, transparencës dhe punës me përgjegjësi gjithmonë në shërbim të qytetarëve. Pikërisht transparencën i dha material mediave dhe palëve të dëmtuara që të ndihmojnë në marrjen e masave konkrete", ka thënë ministri Allagjovovski. "Nëse konstatohet përgjegjësi penale, këtë duhet ta thotë Prokuroria Publike. Ne si Ministri e Kulturës nuk jemi as Prokurori dhe as gjykatë që të mund të bëjmë thirrje për përgjegjësi penale. Si-

pas njohurive tona, diçka e tillë nuk ekziston. Vetë pjesëmarrësit janë duke u tërhequr nga projektet para se gjithash për shkak të kritikave të shumta nga opinioni", deklaroi Allagjovovski, sipas të cilit, dyshimet për keqpërdorime me projekte nuk kalojnë as 1 përqindëshin e mjeteve financiare. "Projektet e dyshimta nuk kalojnë as 1 përqind në aspektin e mjeteve financiare, që në numër i bie rreth 20 projekte. Ky është një rezultat i mirë dhe margjinë e vogël e gabimeve kundrejt një projekti kaq të madh dhe të ndërlikuar. Në përgjithësi vlerësojmë se Programi është i mirë dhe se të gjitha gabimet do t'i zgjidhim deri në fund", u shpreh ministri i Kulturës, Allagjovovski.

Ndryshe, bëhet fjalë për dhjetëra projekte, për të cilët gazeta KOHA disa ditë me radhë, në një seri shkrimesh kishte raportuar për shoqata fiktive që kishin marrë projekte me shumica të mëdha, ndërsa ishin anashkaluar shoqata

dhe organizata tjera që veprojnë me dhjetëra vite në të mirë të kulturës shqiptare në Maqedoni. Konkretisht, ishte Lidhja e Artistëve Shqiptarë "Arta" nga Tetova dhe me përfaqësues Kujtim Saliu ajo që kishte fituar 2.4 milionë për tre projekte, ndërsa e njëjta nuk kishte të regjistruar asnjë veprimtari konkrete për kulturën shqiptare, ndërsa selinë e shoqatës e kishte të regjistruar në një banesë në një lagje të Tetovës, pa ndonjë shënim se aty zhvillohen aktivitete kulturore. Kishte dhe raste tjera nepotizmi, konkretisht tre projektet për bashkëshortët Ismaili nga Karshiaka, e që ishin në lidhje familjare me sekretarëshën e sekretarit shtetëror në Ministrinë e Kulturës, Valmir Aziri. Madje, që të jetë ironia më e madhe, motra e sekretarëshën-shoqatën me të cilën kishte fituar dy projekte, e kishte themeluar dy muaj pasi ishte shpallë konkursi. Projekt i pakupitmtë ishte edhe ajo e shoqatës "Drita" nga Gostivari, e cila kishte fituar mbështetje financiare për promovimin e traditës së synetimit! Gjithashtu, KOHA merr vesh se do të tërhiqet edhe projekti i bashkëpunëtorit të Ministrisë së Kulturës, Arlin Huseini, i cili kishte fituar projekte nga ky Program vjetor.

Shkup, 25 shkurt - Pas serisë së shkrimeve në gazetën KOHA dhe presionit të opinionit, Ministria e Kulturës më në fund ka eliminuar pjesën më të madhe të projekteve të dyshimta që këtë vit, ishin pjesë e Programit vjetor të kulturës. Këtë e ka bërë të ditur vet ministri i Kulturës, Robert Allagjovovski, i cili të dielën ka informuar se rreth 20

projekte, tashmë janë hequr nga Programi vjetor i Ministrisë së Kulturës.

"Dua t'ju informojë se pjesa më e madhe e projekteve të dyshimta tashmë janë tërhequr, për një pjesë presim mendim të Komisionit për Antikorrupsion, ndërsa procedura e ankesave do të japë mundësi që të rregullohen edhe pakëna-

ZHAN KLOD JUNKER VIZITË ZYRTARE NË MAQEDONI

Vendi ka bërë përparim të madh

Zhan Klod Junker përgëzoi Zaevin për atë që ka bërë deri më tani rreth reformave, duke theksuar se vendi ka bërë përparim të madh. Ai u kërkoi autoriteteve maqedonase që vendi sa më shpejt të zgjidh mosmarrëveshjet me Greqinë rreth emrit



ekskluzivisht i takon dy vendeve, ndërsa në pyetjen si e sheh BE ecurinë e reformave të Qeverisë, Junker mes tjerash tha se është e nevojshme edhe angazhimi i menjëhershëm i opozitës në procesin e reformave. Junker njoftoi se do të takohet për pak kohë edhe me presidentin e shtetit, Gjorge Ivanov, dhe më pas do të udhëtojë për në Shqipëri për tu takuar me autoritetet e larta shtetërore atje. Maqedonia është vendi i parë në Ballkan në kuadër të turneut të Junker dhe Hahn, të cilët deri më 1 mars do të vizitojnë gjithë gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndryshe, kryetari i Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker pas vizitës në Maqedoni, turneun e tij në Ballkanin Perëndimor do ta përfundojë më 1 mars në Sofje të Bullgarisë, e cila për momentin udhëheq me Këshillin e Bashkimit Evropian. Zëdhënësi i Zhan Klod Junker para se ë vijë në Shkup, gazetarëve shkurt iu përgjigj se vizita e ardhshme në rajon është pa sqyrim i interesit të ripërtërirë dhe dinamikës, të cilën KE-ja dëshiron ta vendos.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 25 shkurt - Kryeministri Zoran Zaev të dielën priti në Qeveri presidentin e Komisionit Evropian, Zhan Klod Junker, i shoqëruar nga eurokomisioneri për Zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johan Han. "Nuk erdha këtu për të dhënë datën, por erdha t'iu them se Maqedonia është në rrugë të drejtë dhe është dukë përparuar dhe nëse vazhdoni kështu më këtë ritëm - për disa muaj ose në qershor, Komisioni Evropian do ti rekomandojë Kë-

shillit të Bashkimit Evropian për të filluar negociatën për anëtarësim në BE", theksoi Junker në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Zaev. Junker përgëzoi Zaevin për atë që ka bërë deri më tani rreth reformave, duke thënë më tej se vendi ka bërë përparim të madh. Ai u kërkoi autoriteteve maqedonase që vendi sa më shpejt të zgjidh mosmarrëveshjet me Greqinë rreth emrit. Sa i përket anëtarësimit në BE, Junker siguroi se BE do të merr vendime individuale për secilin vend. "Gjatë një

takim në Bruksel, i thash kryeministrit Aleksis Cipars që të dyja vendet duhet të vazhdojnë përpjekjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth emrit. Në këtë drejtim, shoh një përparim me ndërrimin e emrit të aeroportit që ishte një kompromis për negociatën më tej", theksoi Junker. Ndërkaq ishte Zaevi që paraprakisht në rolin e nikoqirit falënderoi zyrtarët e BE-së që zgjedhën Maqedoninë si vendin e parë për ta filluar turin e tyre ballkanik. "Jam i bindur se në qershor, vendi do i nis bisedimet për inte-

grim në Bashkimin Evropian. Mund t'iu them se kanë mbetur edhe pak aktivitete që ky vit të jetë vit historik për Maqedoninë. Mbyllja e çështjeve afatgjate nuk është e lehtë. Të inkurajuar nga Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Bullgarinë, ne u angazhuam seriozisht për të punuar rreth zgjidhjes së çështjes së emrit me Greqinë", theksoi kryeministrin Zaev. Në pyetjen e gazetarëve nëse vendi do të ketë nevojë për diplomacinë evropiane në zgjidhjen e kontestit rreth emrit, Junker ishte decid se kjo çështje

SFIDA E RE NË BALLKAN

RREZIKU QË VJEN NGA RUSIA E TURQIA

Ballkani është rajoni ku Rusia mund të punojë për të destabilizuar BE-në me një kosto shumë të ulët, si nga këndvështrimi financiar, ashtu edhe në rrezikimin e një përballjeje me SHBA. Një tjetër rrezik vjen nga Turqia, ndërsa është e paqarte sesi do t'i luajë kartat e tij në Ballkan presidenti Recep Tayyip Erdogan



Shkup, 25 shkurt - Lufta e Dytë Botërore ka përfunduar, por e para ende jo. Analisti i "The Guardian", Ivan Krastev citon fjalët e një zyrtari të lartë turk për t'iu referuar problemeve gjeopolitike të rajonit të Ballkanit. Duke përmendur fiksimin në rritje të publikut dhe qeverive me kufijtë dhe territoret, analisti pohon se kapaciteti i BE-së për të vepruar në Ballkanin Perëndimor po vihet seriozisht në provë. Përpara se unioni të realizojë ambicien e tij për transformimin e rajonit, ai duhet të jetë i vetëdijshëm për ndryshimet gjeopolitike që po ndodhin atje. Ndërsa në vitin 2003 nuk kishte dyshime mbi të ardhmen europiane të Ballkanit, e Turqia ishte entuziaste për mundësinë

e integritit në BE, sot konkurrenca gjeopolitike është e ashpër. Përmes investimeve të mëdha, sidomos në Serbi, Kina po shtrin gjithnjë e më shumë ndikimin e saj në rajon. Gjithashtu, qasja e Rusisë ndaj Ballkanit ka ndryshuar, - vijon "The Guardian", - dhe Brukseli nuk ka nevojë të ketë një spiun në Kremlin për të ditur se Moska do të bëjë gjithçka për të penguar Maqedoninë t'i bashkohet NATO-s, jo për shkak të rëndësisë strategjike, por për vlerën simbolike të këtij akti. Ballkani është rajoni ku Rusia mund të punojë për të destabilizuar BE-në me një kosto shumë të ulët, si nga këndvështrimi financiar, ashtu edhe në rrezikimin e një përballjeje me SHBA. Një tjetër rre-

zik vjen nga Turqia, ndërsa është e paqarte sesi do t'i luajë kartat e tij në Ballkan presidenti Recep Tayyip Erdogan. "The Guardian" sugjeron se Rusia e Turqia mund të koordi-

nojnë politikat e tyre në rajon, si në rastin e Sirisë, me Ankaranë që mund të përdorë ndikimin te komunitetet myslimane dhe Moskën tek ato ortodokse.

"Nëse BE-ja nuk vepron përballë këtyre realiteteve të reja gjeopolitike, strategjia e saj për Ballkanin Perëndimor do të dështojë", përfundon analisti Krastev.

SHQIPËRIA E MAQEDONIA, VENDET QË PËRÇAJNË BE-në

Anëtarët e ardhshëm përçarës të Bashkimit European. Kështu iu referohet britanikja "Express" Shqipërisë dhe Maqedonisë, vende që - siç thotë ajo, - pritet të nisin bisedimet për anëtarësim këtë verë. E në një sinjal të qartë se blloku është i vendosur për zgjerim, presidenti i Komisionit European, Jean-Claude Juncker, dhe Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn, do të vizitojnë javën e ardhshme të dyja vendet, ashtu si dhe Serbinë, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi e Kosovën. "Kjo lëvizje pritet të sjellë përçarje të mëdha brenda BE-së - thotë "Express", - me disa vende që janë tejet hezituese, përfshirë edhe Gjermaninë, ndërsa të

tjerë duan ta përshpejtojnë procesin". Media britanike përmend deklaratën e Hahn për "Die Welt", kur thotë se KE do të rekomandojë së shpejti, me shumë gjasë në verë, hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Të gjashta vendeve të Ballkanit u është premtuar aderimi që në vitin 2003, por procesi është vonuar për shkak të shqetësimeve se nuk është bërë mjaftueshëm për plotësimin e kushteve. "Ndarjet brenda BE-së u panë edhe gjatë takimit të ministrave të Jashtëm në Bullgari javën e kaluar", vijon "Express". Ministri i Jashtëm gjerman, Sigmar Gabriel tha pas takimit se situata në Serbi dhe Kosovë ishte e vështirë.

PAGAT E PRESIDENTËVE TË RAJONIT

Thaçi rekord, Vuçiqi dhe Ivanovi të fundit

Paga e Hashim Thaçit është pothuajse tetë herë më e lartë se paga mesatare, kurse tre anëtarët e Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës marrin pagë shtatë herë më të lartë se paga mesatare në atë vend



Shkup, 25 shkurt - Janë bërë publike pagat e presidentëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe pagën e presidentit sloven. Pagat më të mëdha i kanë anëtarët e Presidencës së Bosnje dhe Hercegovinës (tre sish) dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, krahasuar me pagën mesatare në vendet e tyre. Sipas të dhënave të fundit zyrtare të publikuara, pagën më të madhe mujore në rajon e ka presi-

identi i Sllovenisë, Borut Pahor. Siç thuhet në formularin e tij të pasurisë, të dorëzuar në Komisionin Zgjedhor, të ardhurat e tij mujore arrijnë në 3322 euro.

Siç raporton portali Al Jazera, mbi 3000 euro janë pagat mujore të presidentes kroate Kolinda Grabar-Kitarović dhe anëtarëve të Presidencës së Bosnje dhe Hercegovinës. Komisioni për Konflikt Interesimi vendos që Grabar-Kitarović ka një pagë neto afër 3276 euro, ndërsa anëtarët e Presidencës së BeH fitojnë mesatarisht

nga 3091 euro. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnjës dhe Hercegovinës thekson se anëtarët e Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Bakir Izetbegović, Dragan Çović dhe Mladen Ivanović marrin 2862, 2874 respektivisht 3536 euro në muaj. Sipas të dhënave publike, presidenti i Serbisë ka një pagë trefish më të ulët se ajo presidentëve kroatë dhe boshnjakë. Aleksandar Vuçiq merr 1083 euro në muaj, që është paga më e vogël presidenciale në rajon. Presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanović, merr pagë



mujore prej 2443 euro, kurse Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi 2873 euro.

Më pak se 2000 euro në muaj marrin pagë Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov (1250) dhe ai i Shqipërisë Ilir Meta (1425). Nëse krahasojmë të ardhurat presidenciale me pagën mesatare në rajon, rekordmenë absolutë me paga të larta janë presidenti i Kosovës dhe anëtarët e Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës. Paga e Hashim Thaçit është pothuajse tetë herë më e lartë se paga mesatare, kurse

tre anëtarët e Presidencës së Bosnjë dhe Hercegovinës marrin pagë shtatë herë më të lartë se paga mesatare në atë vend. Presidentët e Kroacisë, Maqedonisë dhe Sllovenisë marrin paga tre herë më të larta se paga mesatare në vendin e tyre, ndërsa presidenti i Serbisë merr dyfishin e pagës mesatare në Serbi. Sipas të dhënave më të fundit statistike zyrtare, pagat mesatare më të larta në rajon janë në Slloveni dhe Kroaci, kurse më të ulëtat në Maqedoni dhe Bosnjë e Hercegovinë.

"Fillimisht do të ketë rikonstrukcion, sepse para së gjithash do të rritet numri i deputetëve në grupin e deputetëve. Po bisedojmë me deputetë plotësues. Mendoj se duhet të mundësojmë stabilizim të Parlamentit nga më shumë aspekte", ka thënë Zaevi

Shkup, 25 shkurt - Unë e dërgova mesazhin që dikush të mund të korrigjohet. Absolutisht nëse dikush meriton ndërrim menjëherë kjo bëhet. Pa dallim se nëse është në eshlonet më të ulët ose më të lartë. Presim që gjithësi të ndodhin edhe rikonstrukcione dhe ndryshime në periudha përkatëse kohore kur bëhen rikapitularë nga çdo aspekt i mundshëm. Kështu ka thënë kryeministri Zoran Zaev, duke konfirmuar deklaratën e ditëve më parë se do të ketë rikonstrukcion qeveritar jo më vonë se në pranverë, konkretisht gjatë muajit të ardhshëm.

"I madh është numri i njerëzve në Qeveri të cilët shumë mundohen e nuk dinë, por mundohen edhe të mësojnë. Ka një pjesë të cilët as nuk dinë e as nuk mundohen. Unë apeloj deri tek të gjithë. Ne kemi servis të qytetarëve, për atë shkak jemi vendosur, që t'u përkushtohemi maksimalisht

KONFIRMOHEN NDRYSHIMET E QEVERISË

RIKONSTRUIM DHE ZGJERIM TË SHUMICËS QEVERTITARE



nevojave të qytetarëve. Këtë të cilën e kemi marrë nga ata është nder dhe përgjegjësi, të cilën nuk ka pasur mundësi secili ta marrë. Nga ky aspekt me të vërtetë apeloj deri tek të gjithë, që me të vërtetë t'u kushtohen maksimalisht realizimit të detyrave të tyre", tha Zaevi, duke shtuar se krahas rikonstrukcionit të kabinetit qeveritar, mund të ketë edhe rritje të numrit të deputetëve në grupin e deputetëve.

"Fillimisht do të ketë rikon-

struksion, sepse para së gjithash do të rritet numri i deputetëve në grupin e deputetëve. Po bisedojmë me deputetë plotësues. Mendoj se

duhet të mundësojmë stabilizim të Parlamentit nga më shumë aspekte. Unë shpresoj se edhe opozita do të kthehet shpejt në Parla-

ment, por edhe numri i përgjithshëm i deputetëve nga shumica parlamentare do të duhet të jetë më adekuat, që të mund të mos ketë ndërprerje të këtylla të seancave, pauzave, grumbullim të deputetëve ose ngjashëm. Besoj se do të kemi sukses me këtë, ndërsa për shkak të kësaj do të ndodhë gjithësi se edhe rikonstrukcion", tha kryeministri Zaev. Ndryshe, çdo ditë e më shumë shtohen zërat se pjesë e Qeverisë mund të bëhen edhe deputetët e Lëvizjes BESA, si dhe PDSH e Menduh Thaçit. Të dy krahet e BESËS, ajo e Bilall Kasamit dhe e Afrim Gashit, nuk e kanë fshehur se duan të jenë pjesë e shumicës qeverisëse, ndërkohë që deklaratë të prerë deri tani nuk ka pasur vetëm PDSH e Menduh Thaçit. Nga ana tjetër, po thellohen largësitë mes ish-partnerëve qeveritarëve: Aleanca për Shqiptarët dhe LSDM e Zaevit. (F.R)

500 MILIONË EURO ËSHTË GROPA E FONDIT PENSIONAL

Kryeministri i Qeverisë në pyetjen se nëse do të ketë rritje të kufirit të moshës për shkuarje në pension, megjithëse theksoi se tani për tani nuk mendohet për ndryshim, ai e la të hapur, siç tha ai, stabilizimin e Fondit pensional. "Duhet ta stabilizojmë Fondin pensional. Shteti nga buxheti

jep 500 milionë euro që pensionistët të mund të marrin pension. Derisa punëtorët nuk fillojnë ta mbushin fondin pensional, e jo shtetin, atëherë do të fillojmë të mendojmë për ndryshim të kufirit të moshës për shkuarje në pension, por drejt uljes së tij", u përgjigj Zaev.

"METRON ANALIZIS" PUBLIKON ANKETËN E RADHËS

Emri dhe skandali "Novartis" përcaktojnë fituesin në Greqi

Kryetari i "Metron Analizis", agjencia që e realizoi hulumtimin, për "To vima" analizon se Qeveria aktuale greke është në humbje për shkak të çështjes për emrin, por fiton pikë lidhur me skandalin me kompaninë farmaceutike

Athinë, 25 shkurt - Është i ndarë mendimi i grekëve lidhur me atë se nëse ekziston hapësirë për zgjidhje kompromise të kontestit me emrin e pranuar nga të dyja palët. Sipas hulumtimit të mendimit publik të publikuar në gazetën "To vima", siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, 49 për qind e të anketuar-

ve konsiderojnë se ekziston hapësirë për zgjidhje, ndërsa madje 46 për qind janë përgjigjur negativisht në pyetjen për marrëveshje eventuale midis dy vendeve. Bisedimet për emrin dhe skandali "Novartis", dy temat më të mëdha në Greqi nga periudha e kaluar, sipas sondazhit i cili është më i madhi i realizuar deri tani, janë pikat kryesore që e përcaktojnë skenën politike tek fqinji jugor.

Kryetari i "Metron Analizis", agjencia që e realizoi hulumtimin, për "To vima" analizon se Qeveria aktuale greke është në humbje për shkak të çështjes për emrin, por fiton pikë lidhur me skandalin me kompaninë farmaceutike. Tek opozita, situata është e kundërt. "Qeveria duket se po humb për shkak të çështjes së Maqedonisë, ndërsa madje opozita humb për shkak të skandalit 'Novartis', ndërsa të dy rastet janë njëri përkundër tjetrit, ndoshta sepse edhe që të dyja çë-

shtjet janë ende në vijim dhe vështirë mund të caktohet se si do të përfundojnë", shkruan Stratos Farnas, kryetari i Agjencisë "Metron Analizis", transmeton MIA.

Në pyetjen se cili është problemi më i madh me të cilin ballafaqohet vendi në këtë moment, 39 për qind e të anketuarve kanë thënë se ajo është ekonomia, 19 për qind papunësia, 11 për qind politikanët dhe sistemi politik, ndërsa vetëm 9 për qind kanë përgjigjur se ajo është politika e jashtme dhe çështja me Maqedoninë. Rezultatet nga hulumtimi tregojnë se Demokracia e Re opozitare edhe më tej është në epërsi para SYRIZA-s qeveritare, por me dallim të zvogëluar, ndërsa madje është rritur rejtingu i partisë radikale djathtë Agimi i Artë. Më konkretisht, sipas sondazhit: Demokracia e Re ka 34,9 për qind, SYRIZA 25,2, Agimi i Artë 9,4, Lëvizja për Ndryshim 8,4, partia Komuni-



ste 7 për qind, Lidhja e centralistëve 3 për qind, Grekët e Pavarur 2,5 për qind. Shumica e të anketuarve (64 për qind) konsiderojnë se në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Greqi, Demokracia e Re do të jetë e para, ndërsa madje 21 për qind kanë thënë se do të fitojë SYRIZA.

Lidhur me atë se cili është më adekuat për kryeministër të ven-

dit, 22 për qind janë përgjigjur se është Kirjakos Micotakis, lideri i Demokracisë së Re, 18 për qind Aleksis Cipras, ndërsa 45 për qind e të anketuarve e kanë zgjedhur përgjigjen: askush. Shtatëdhjetë e dy për qind e grekëve mendojnë se vendi po ecë në drejt të gabuar, ndërsa përqindje aq të njëjtë e atyre që negativisht e kanë vlerësuar punën e Qeverisë greke.

REFORMAT NË KËSHILLIN GJYQËSOR NËN LLUPËN E SEKTORIT CIVIL

TË MOS PREKET TRANSPARENCA

Pas paralajmërimit të ndryshimeve të reja në ligj, Organizatat civile kërkojnë që të mos preket neni që rregullon transparencën e Këshillit gjyqësor, ashtu siç u votua në dhjetor të vitit të kaluar

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 25 shkurt - Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria duhet t'i përmbushin premtimet e tyre sa i përket transparencës së Këshillit Gjyqësor, respektivisht dispozitat ligjore që e mundësojnë rritjen e transparencës së këtij organi të mos shfuqizohen ashtu siç është paralajmëruar. Ky apel së fundmi është përfshirë në Raportin e Propozim-Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe atë për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve, të cilin e ka përgatitur Instituti për të drejtat e njeriut dhe Instituti për politikë evropiane. Në elaborimin e zhvillimeve të dy mujave të kaluar, kur flasim për aktivitetet, Këshillit Gjyqësor në këtë Raport theksohet se ndryshimet e fundit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor, që Parlamenti i miratoi në dhjetor të vitit të kaluar, parapanë publikimin e proceverbaleve të seancave publike në faqen e internetit të Këshillit, si dhe procesverbalet e votimeve dhe zgjedhjeve.

"Në këtë mënyrë u krijua një bazë më e fortë ligjore sa i përket rritjes së transparencës së Këshillit



Gjyqësor. Paralelisht mediave, edhe qytetarëve ju mundësua që të njihen nga afër me detajet e çdo seancë të mbajtur. Mirëpo, për dalim të miratimit të këtyre ndryshimeve, me propozimin e fundit të muajit janar, parashihet shfuqizimi i dispozitave të cilat u votuan një muaj më parë. Vlerësojmë se ky propozim është plotësisht i panevojshëm dhe kontradiktor me vlerësimin e dhënë për gjendjen e transparencës në Këshillin Gjyqësor. Kjo, posaçërisht mund të pasqyrohet me angazhimin dhe përpjekjet e Qeverisë për rritjen aktive të transparencës të institucioneve dhe hapjen e plotë të tyre ndaj qytetarëve", thuhet në Raportin e fundit të sektorit civil. Krahas vërejtjeve dhe kundërshtimeve për

shfuqizimin e dispozitave për transparencën e Këshillit Gjyqësor, pjesë e Raportit të sektorit civil janë edhe disa pika tjetër të propozim-ligjit për këtë Këshill. Qoftë në dispozitat aktuale, por edhe në ato që pritet të miratohen në të ardhmen, sipas Institutit për të drejtat e njeriut dhe Institutit për politikë evropiane, nuk është e precizuar

mjaftueshëm procedura për vërtetimin e përgjegjësisë eventuale të anëtarëve të Këshillit.

"E nevojshme është që të parashihet mundësia për thirrjet e anëtarëve të Këshillit në një lloj përgjegjësie nga ana e organeve që i kanë zgjedhur (në këtë rast Parlamentit të Maqedonisë), e cila dallon nga përgjegjësia penale

eventuale e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor", potencohet në Raport. Pjesë e këtij Raporti janë gjithashtu edhe dispozitat e propozim-ligjit për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve. Me qëllim menjanimin e situatave të palakmueshme, të cilat dyshohet se kanë ndodhur viteve të kaluara, me dorëzimin e diplomave false për njohjen e gjuhëve të huaja nga kandidatët, Institutet e apostrofuar propozojnë harmozimin e Ligjit për Gjykata me Ligjin për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve, të cilët janë në procedurë parlamentare. Konstatimi i cili përmendet në Raport ka të bëjë me kufizimin e prejardhjes së diplomave (certifikatave) për njohjen e një gjuhe të huaj të Bashkimit Evropian. Përveç këtij kushti, organizatat civile propozojnë që të bëhet kufizimi i testuesve zyrtar për gjuhët e huaja në vendin tonë, ose provimi për njohjen e gjuhëve të bëhet në suaza të provimit pranues për në Akademi.

SKANDALI NË "25 MAJI", PADI PENALE EDHE PËR NJË PERSON

Njësitë për tregti me njerëz nga Sektori për krim serioz dhe të organizuar pranë MPB-së deri në Prokurorinë Publike ka ngritur padi penale kundër 42 vjeçares me inicialet M.D. nga Kavadarit, e cila dyshohet për keqpërdorim të 13 vjeçares së mitur nga qendra e kujdesit "25 maji". Nga MPB-ja njoftojnë se sipas të dhënave të dokumentuara, është vërtetuar se e dyshuara, gjatë dhjetorit të vitit

të kaluar dhe janarit të këtij viti e ka detyruar të miturën R.I. e shtruar në qendrën për kujdes social "25 maji" të japë shërbime seksuale për disa persona, për një shumë të caktuar të parave. Poashtu e dyshuara e ka detyruar viktimën që të lypë në rrugë në llogari të saj. M.D. mbahet në stacionin policor në Kisella Vodë dhe gjatë ditës do të dërgohet për t'u marrë në pyetje në Gjykatën Themelore Shkupi 1.

MUNGOJNË METODAT ATRAKTIVE TË MËSIMIT

Kimia dhe fizika, të frikshme për nxënësit

Janë lëndë të cilat mund të mësohen dhe kuptohen shumë lehtë, po që se mësimdhënësit e këtyre atyre lëndëve arrijnë të gjejnë format e duhura, pra nëse përdorin metoda atraktive dhe e bëjnë orën e mësimi interesante për nxënësit

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 25 shkurt - Prirja e nxënësve për të shmangur shkencat natyrore si zgjedhje për të studiuar në ndonjërin prej tyre, padyshim se ka një arsye. Kjo, sipas profesorëve lidhet me përvojën jo të mirë që

kanë nxënësit në fazat e përparme të shkollimit. Në arsimin e mesëm dhe fillor mungojnë metodat e mësimi kreativ, vërejnë ato. Prandaj, lëndët si fizika, kimia, matematika dhe të ngjashme shihen me frikë nga nxënësit, pasi paraprakisht është rrenjosur bindja se janë lëndë të vështira. Por, në të vërtetë, sipas profesorit të Fizikës, Bashkim Ziberi, janë lëndë të cilat mund të mësohen dhe kuptohen shumë lehtë po që se mësimdhënësit e këtyre atyre lëndëve arrijnë të gjejnë format e duhura, pra nëse përdorin metoda atraktive dhe e bëjnë orën e mësimi interesante për nxënësit. Fatkeqësisht, nuk ndodh kështu në shkollat tona.

Kjo gjendje e cila mbizotëron në pjesën dërmuese të shkollave në instanca të fundit reflektohet në numrin e vogël të atyre që regjistrohen në Fakultetet e shkencave natyrore dhe teknike. Madje, në këto fakultete është edhe përqindja më e lartë e atyre që nuk i

përfundojnë studimet e që rëndomë dorëzohen, menjëherë pas vitit të parë. "Nëse mungojnë njohuritë elementare të një lëndë të caktuar, është e pamundur që ato boshllëqe të rikuperohen rrugës ose gjatë viteve të studimit. Sepse në fakultet, studimi i lëndëve të caktuara është i avancuar dhe ashtu si në çdo shkencë tjetër, edhe në kimi, fizikë apo matematikë, nuk ka hapësirë dhe kohë për mësimin e gjërave elementare", vëren Ziberi. Sipas tij, është shumë e kuptueshme që studentët duke matur forcat e veta, të gjykojnë vetë nëse mund t'ia dalin mbanë të studiojnë nëpër këto fakultete ose jo. "Kur dikush është i vetëdijshëm për nivelin e dijeve që ka në një sferë e caktuar në rastet kur ato të njëjtë nuk mjaftojnë, sigurisht që është më mirë të regjistrohen në fakultete të tjera ku dijet e tyre përkojnë me nivele më të kënaqshme". Këtë mendim ndan edhe profesori Neritan Turkeshi, i cili pohon se "është më mirë zgjedhja e një

fakulteti ku ndjehemi të sigurt, sepse në ditën e sotme - nuk vlen një diplomë pa dije".

Edhe nëse arrijmë ta fitojmë një diplomë, ajo nuk ka vlerën që duhet të ketë nëse jemi të paafte të vemi në zbatim shkathtësitë për të cilat jemi kualifikuar. "Në këtë drejtim tregu i punës nuk të fal. Atij i duhen njerëz të aftë për kualifiko të caktuara, ndërsa universitetet duhet të orientojnë kuadrot sipas nevojave të atij tregu", shprehet Turkeshi. Për momentin, tregu i punës ka nevojë për kuadro të shkencave natyrore. Prandaj të rinjtë duhet të përcaktohen për këta lloj studimesh të cilat fatmirësisht janë në numër edhe në universitete në gjuhën shqipe, plotëson Turkeshi. Megjithatë, imperativ i kohës mbete edhe angazhimi i shkollave në sistemin para universitar të arsimit për orientimin e nxënësve drejt shkencave natyrore. Profesori Ziberi, vëren se duhet të ndryshojë metodologjia e mësimi të këtyre


lëndëve. "Mësuesit dhe arsimtarët duhet të bëjnë më tepër përpjekje për të bërë interesante lëndët e shkencave matematike-natyrore. Aplikimi i metodave atraktive të mësimi do të ndihmon nxënësit për tu afruar më tepër me shkencat natyrore, pra do të krijon një relacion më miqësor", shprehet ai.

Por krahas mësimdhënësve, përpjekja duhet të jetë në radhë të parë institucionale. Tani që në Maqedoni është hapur dera për ndryshime në sistemin arsimor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të trajtojë me më shumë seriozitet edhe këtë element të reformës, pra të angazhojë ekspertët më të mirë të fushës për të caktuar edhe standardin e metodave dhe metodologjive të mësimi për secilën lëndë veç e veç. Në të kundërtën, reforma nuk mund të jetë e plotë, gjithçka do të jetë e përkohshme dhe provizore nëse nuk preket në thelb arsimit, pra nëse nuk ndryshojnë metodat e mësimdhënies.

Teprica e të punësuarve në administratë prej vitit 2019 do ti ofrohet sektorit privat. Përfaqësuesit e biznesit thonë se kërkesat e kompanive private për kuadro vështirë se mund të mbulohen nga sektori publik

RISISTEMIMI I ADMINISTRATËS SHTETËRORE

TEPRICA TEK BIZNESI PRIVAT



NUK DO TË KETË LËSHIME NGA PUNA
Qeveria do të subvencionojë diku tërësisht dhe diku pjesërisht pagat në sektorin privat e të punësuarve që do të kalojnë nga sektori shtetëror në sektorin privat për një periudhë të caktuar me qëllim që privati të ketë interes të angazhojë këto persona. Gjithashtu nuk do të ketë lëshime nga puna dhe askush nuk do të detyrohet për një gjë të tillë që pa vullnetin e tij të kalojë nga administrata në sektorin privat.

riudhë të caktuar me qëllim që privati të ketë interes të angazhojë këto persona. Nga ky dikaster thonë se nuk do të ketë lëshime nga puna dhe askush nuk do të detyrohet për një gjë të tillë që pa vullnetin e tij të kalojë nga administrata në sektorin privat. Do të ekzistojë edhe dialog në dy drejtime me komunitetin e biznesit, por edhe në bazë të analizës funksionale që do të tregojë tepricën e punonjësve në admini-

stratë që gradualisht prej vitit të ardhshëm të zvogëlohet numri i të punësuarve në administratën shtetërore. Përfaqësuesit e biznesit thonë se kërkesat e kompanive private për kuadro vështirë se mund të mbulohen nga sektori publik, ndërsa nga ana tjetër edhe administrata vështirë se do të pajtohet të ndryshojë vendin e punës me privilegje të shumta.

"Nuk besoj se kjo ide do të realizohet në praktikë për shkak se nevojat e biznesit janë shumë më të larta se ajo çka ofron administrata. Nëse kompanive private ju nevojitet kuadro të profileve të caktuara, ato do të investojnë që nga fillimi në krijimin e kuadrit të nevojshëm. Ka mundësi që një pjesë e të rinjve të angazhuar në administratë që kanë prirje për sipërmarrje të gjejnë veten që me pako të caktuar financiare të hapin biznese të reja", thotë afaristi Goran Rafajllovski. Sipas tij

një nga zgjidhjet e problemeve me tepricën e të punësuarve në administratë është që atij që ndjehet i aftë për të nisur biznes, ti ofrohen paga për 24 muaj me qëllim që të kalojë në sektorin privat, duke e ndihmuar edhe në rikualifikim si dhe me kredi të buta. Njohësit e administratës në Maqedoni thonë se në kushte kur kemi papunësi të lartë prej afër 25 për qind si dhe ekonomi informale prej afër 30 për qind, me siguri se edhe sektori publik është tejet i madh për një ekonomi të dobët të varur nga borxhet e reja, dërgesat e mërgimtarëve, por edhe eksportin që kryesisht realizohet nga investitorët e huaj dhe shumë më pak nga kompanitë vendore. Vlerësohet se mbipunësimi më i madh mund të vërehet në ndërmarrje të caktuara publike si dhe organe, agjenci dhe organizata të tjera që paguhen nga arka e shtetit. Në 129 ndërmarrje publike në tërë Maqedoninë janë

MBINGARKESË E ARKËS SHTETIT

Mbipunësimi më i madh mund të vërehet në ndërmarrje të caktuara publike si dhe organe, agjenci dhe organizata të tjera që paguhen nga arka e shtetit. Në 129 ndërmarrje publike në tërë Maqedoninë janë të punësuar bile 17.872 persona tregon Regjistri i të punësuarve në sektorin publik. Kjo paraqet një dyfishim të të punësuarve në këto kompani në raport me dhjetë vite më parë.

të punësuar bile 17.872 persona tregon Regjistri i të punësuarve në sektorin publik. Kjo paraqet një dyfishim të të punësuarve në këto kompani në raport me dhjetë vite më parë. Sipas të dhënave të Avokatit të Popullit në vitin 2007, në ndërmarrjet publike kanë qenë të punësuar 8.299 persona, që do të thotë dyfishimin e tyre në periudhën 2007-2017. Gjithashtu, çdo e katërta kompani ka punuar me humbje në vitin e kaluar. Nga ana tjetër vetëm në shëndetësi përkundër nevojës së madhe për punësimin e motrave medicinale, të mjekëve të përgjithshëm që me kohë përmes një procesi të gjatë dhe mundimshëm do të specializojnë, por edhe specialistëve të gatshëm për punë, shumë pak angazhohet një kuadër i tillë më se i nevojshëm për funksionimin e sistemit shëndetësor nën arsyetimin e mungesës së buxhetit për pagesën e tyre.

PROCEDURAT DOGANORE

Asnjë lehtësim për mërgimtarët

Nga Dogana sqarojnë se edhe mërgimtarët pas kthimit në vendlindje nuk janë të liruar nga pagesa e kompensimeve për importin e materialeve shtëpiake dhe afariste

Shkup, 25 shkurt - Mërgimtarët që kthehen në atdhe me gjësende të ndryshme shtëpiake apo edhe të dedikuara për prodhimtari aspak nuk janë të liruar nga pagesa e tatimeve dhe doganës. Gjithashtu, mobiljet me vlerë deri në 800 euro për

përdorim personal tatimohen me 18 për qind TVSH dhe 15 për qind doganë, ndërsa gomat e reja i nënshtrohen pagesës prej 31 për qind të tatimit dhe doganës. Këto janë vetëm disa nga pyetjet më të shpeshta të parashtruara ndaj Doganës nga ana e qytetarëve lidhur me lehtësimet eventuale për mallrat e ndryshme që blihen jashtë dhe importohen në vend. Nga Dogana sqarojnë se edhe mërgimtarët pas kthimit në vendlindje nuk janë të liruar nga pagesa e kompensimeve për importin e materialeve shtëpiake dhe afariste.

Në bazë të Ligjit për procedurë doganore, shkalla e doganës për mobilje lëviz prej 10-15 për qind në varësi prej mobiljeve dhe materia-

lit prej të cilit është prodhuar. Shkalla e doganës për aparate në amvisëri është 15 për qind, ndërsa TVSH është 18 për qind. Në bazë të legjislacionit doganor, në Maqedoni nuk parashikohet lirim nga pagesa e doganës dhe kompensimeve të tjera si TVSH për mjete të ndryshme për mërgimtarët që i importojnë gjatë kthimit të tyre në Maqedoni.

Nga ana tjetër, gjatë importit të mobiljeve nga jashtë për përdorim personal dhe në sasi që nuk udhëzojnë se do të keqpërdoren për shitje, procedura realizohet në pikën doganore ku kërkohet llogaria apo fatura e mallit. Nëse malli ka vlerë deri 800 euro, atëherë i nënshtrohet pagesës prej 15 për qind të doganës dhe 18 për qind të

TVSH-së, ndërsa në rast se malli ka vlerën më të madhe se 800 euro, atëherë zbatohen shkallët më të larta të doganës, të cilat do të realizohen nga ana e përfaqësuesit doganor që duhet ta angazhoni. Veturat i nënshtrohen edhe pagesës prej 13 për qind për importin e gomave të reja të jashtme, por edhe të brendshme. Ky total fitohet në bazë të vlerës së faturës plus harxhimeve manipuluese dhe transportuese. Njëherazi, vlera e TVSH-së për importin e gomave është 18 për qind. Lidhur me dilemën se a paguhet kompensim për prodhimin që kushton 34.88 dollarë, nga Dogana thonë se të gjitha dërgesat që përmbajnë mallra të ndryshëm dhe janë të dërguar nga jashtë nga

ana e personave juridik, si dhe të gjitha dërgesat që janë objekt i shitblerjes i nënshtrohen kompensimeve doganore dhe TVSH-së, paravarsisht se a shërbejnë për përdorim personal të pranuesit. Nga pagesa e doganës lirohen vetëm dërgesat, vlera e të cilave nuk i tejkalon 45 euro, ndërsa nga pagesa e TVSH-së lirohen të gjitha dërgesat, vlera e të cilave nuk tejkalon 22 euro - që do të thotë se për dërgesat me vlerë deri në 45 euro, paguhet vetëm TVSH.

Nëse dëshironi që përmes internetit të blini aparat për EKG që kushton 500 deri 600 euro, i njëjti është i liruar nga dogana, por nevojitet leje e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. (F.P)

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës me shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, me adresë në Bul. 8 Shtetmvi nr. 13, PUBLIKON

SHPALLJE për punësim

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës me shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup ka nevojë të punësorëve 10 (dhjetë) punëtor në vendin e punës:

1. Mirëmbajtës të higjienës – 3 (tre) persona;
2. Sigurim – 2 (dy) persona;
3. Udhëheqës në shërbimin për menaxhim me Akua Park, Patinazh dhe fitnes qendër;
4. Udhëheqës në sektorin për shitje;
5. Kamerier;
6. Instruktor në fitnes qendrën dhe
7. Koordinator për patinazh .

Kushtet e kërkuara:

- **Mirëmbajtës të higjienës** – PMP/pa shkallë të arsimit, 1 vit përvojë pune përkatëse
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 08:30h- 15:30h; ndërrimi i dytë prej ora 15.30h – 22.30h
 - Orari javor i punës: e hënë – e diel;
 - Punëtori do të punojë në ndërrime;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 13.000,00 denarë.
- **Sigurim** – PMP/ 1 vit përvojë pune dhe licencë për sigurim të pronës
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 07:00h- 19:00h; ndërrimi i dytë prej ora 19.00h – 07.00h
 - Orari javor i punës: e hënë – e diel;
 - Punëtori do të punojë në ndërrime;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 15.000,00 denarë.
- **Udhëheqës në shërbimin për menaxhim me Akua Park, Patinazh dhe fitnes qendrën** – Fakultet të edukatës fizike me së paku 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit/ 2 vjet përvojë pune përkatëse
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 08:30h- 15:30h; ndërrimi i dytë prej ora 15.30h – 22.30h
 - Orari javor i punës: e hënë – e diel;
 - Punëtori do të punojë në ndërrime;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 26.000,00 denarë.
- **Udhëheqës në sektorin për shitje** – Arsim sipëror / 3 vjet përvojë pune përkatëse
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 08:30h- 16:30h;
 - Orari javor i punës: e hënë – e premte;
 - Punëtori do të punojë në ndërrimin e parë;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 24.000,00 denarë.
- **Kamerier** – PMP/ pa përvojë pune
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 09:00h- 16:00h; ndërrimi i dytë prej ora 14.00h – 22.00h
 - Orari javor i punës: e hënë – e diel;
 - Punëtori do të punojë në ndërrime;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 13.000,00 denarë.
- **Instruktor në fitnes qendrën** – PMP/ 1 vit përvojë pune përkatëse
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 07:00h- 15:00h; ndërrimi i dytë prej ora 15.00h – 23.00h
 - Orari javor i punës: e hënë – e diel;
 - Punëtori do të punojë në ndërrime;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 14.000,00 denarë.
- **Koordinator për patinazh** – PMP/ 1 vit përvojë pune përkatëse
 - Orari ditor i punës: ndërrimi i parë prej 07:00h- 15:00h; ndërrimi i dytë prej ora 15.00h – 23.00h
 - Orari javor i punës: e hënë – e diel;
 - Punëtori do të punojë në ndërrime;
 - Shuma në të holla e neto pagesës bazë: 26.000,00 denarë.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë;

Afati për zgjedhje zgjatë 2 (dy) ditë.

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë me CV dhe letrat e tyre të motivimit vetëm në arkivin e shoqërisë, në zarf të mbyllur, më së voni deri më 02.03.2018 (e premte).

Të dhënat për punëdhënësin:

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës me shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup, Personi për kontakt, Danica Sokolovska / e-mail: danica.sokolovska@scboristrajkovski.gov.mk, Adresa bul. 8 Shtetmvi nr. 13

BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup
Drejtuues
Aleksandar Petrovski

REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI"
SHKUP
INSTITUTI PËR BLEGTORI
Bul. "Ilinden" nr. 92-a, Shkup
tel. ++389-02-306 51 20
e-mail: inst.stoc.mk@gmail.com



REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITY "St. CYRIL AND METHODIUS"
SKOPJE
INSTITUTE OF ANIMAL SCIENCE
bul. "Ilinden" br. 92-a, Skopje
tel. ++389-02-306 51 20
e-mail: inst.stoc.mk@gmail.com

Në bazë të nenit 289 të Statutit të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" nga Shkupi dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" nga Shkupi (numër 173/2011), Këshilli shkencor i UKIM Instituti për blegtori Shkup ka sjellë Vendim që të publikojë:

KONKURS

Për zgjedhje punëtorit shkencor në të gjitha titujt shkencor

- Një punëtor shkencor në të gjitha titujt shkencore në sferën shkencore *Mikrobiologji*

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e parapara me Ligjin për veprimtari shkencore-hulumtuese (Gazeta Zyrtare e RM nr. 46/08).

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm (Diplomë për arsim të mbaruar sipëror, Diplomë për studime të mbaruara postdiplomike të ciklit të dytë dhe të tretë, biografi të shkurtë, listë të punimeve të publikuara dhe nga një kopje prej tyre), kandidatët duhet ti dorëzojnë deri në Këshillin shkencor të UKIM Instituti për blegtori Shkup në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e publikimit të konkursit në adresë: UKIM Instituti për blegtori, bul. Ilinden 92A, F. P 207, 1000 Shkup.

Drejtor,
Prof. D-r. Rodne Nastova

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të LMP (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15) si dhe nenit 80, 82 pika 1 dhe 3 dhe 85 të Ligjit për arsim fillor Tekst i konsoliduar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/16) SHFK "Tosho Vellkov – Pepeto" Kavadar për vitin shkollor 2017 / 2018 publikon

SHPALLJE

Për praninë të përmbuesve për kohë të caktuar të punës më së voni deri në kthimin e punëtorit/es që mungon (pushim të lindjes).

1. 1 mësimdhënës të fizikës për 14 orë mësimore dhe pagesë fillestare prej 14.465,00 den.
2. 1 mësimdhënës të matematikës për 6 orë mësimore dhe pagesë fillestare prej 6.200,00 den.
3. 1 mësimdhënës të gjuhës maqedonase për 12 orë mësimore dhe pagesë fillestare prej 12.401,00 den.

Orari i punës së mësimdhënësve është me dy ndërrime edhe atë ndërrimi i parë prej ora 7.30 deri në ora 13,30 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12.30 deri në ora 18,30, çdo ditë prej ditës së hënë deri ditën e premte në pajtim me orarin e orëve për vitin shkollor 2017/2018.

Krahas kushteve të përgjithshme të LMP, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e parapara me Ligjin për arsim fillor.

Krahas lutjes kandidatët duhet të parashtrajnë

-certifikatë ose diplomë për arsim të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter)

-certifikatë të shtetësisë

Lutjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Kontrollimi për njohuri të gjuhës maqedonase për kandidatët të cilët do të konkurrojnë do të bëhet më datë 06.03.2018 në ora 11 në lokalet e shkollës.

Dokumentet të parashtrohen në shkollë.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit

SHFK "Tosho Vellkov – Pepeto"
Kavadar
Tel/faks 043-418-191

Në bazë të nenit 89-a paragrafi 1 alineja 5, nenit 91 paragrafi 2 dhe nenit 92-a e Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/2015, 30/2016 dhe 67/2017) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të R. M – Teksti i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15), Shkolla e mesme profesionale komunale "Dimitrija Çupovski" – Veles, ndërsa në bazë të Vendimit nr. 08-780/2 të datës 15.02.2018 nga Kryetari i Komunës së Velesit, si dhe Vendimit nr. 02-128/5 të datës 19.12.2018 nga Këshilli i shkollës së SHMPK "Dimitrija Çupovski" nga Velesi, i njëjti publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

për zgjedhje të drejtorit të SHMPK "Dimitrija Çupovski" nga Velesi

1 Kandidatët për Drejtor të SHMPK "Dimitrija Çupovski" nga Velesi krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushen edhe kushtet në vijim:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror;
 - Të përmbushin kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme;
 - Të kenë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së R. Maqedonisë;
 - të kenë të dhënë provimin për drejtor të shkollës së mesme;
 - Në momentin e zgjedhjes, me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës;
 - të jenë psikofizikisht të aftë për punë;
 - të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
2. Kandidatët për Drejtor të Shkollës duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtë (CV);
 - Diplomë për arsim të mbaruar sipëror (original ose kopje të vërtetuar në noter);
 - Vërtetim për 5 (pesë) vjet përvojë të punës në punë edukativo-arsimore të dhënë nga institucionet e verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM;
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor në pajtim me Ligjin për arsim të mesëm;
 - Certifikatë të shtetësisë;
 - certifikatë nga evidenca penale se nuk ka aktakuzë që është futur në fuqi juridike, as nuk është sjellë vendim joiploftëfuqishëm gjyqësor;
 - vërtetim për evidencë ndëshkuese se nuk janë evidentuar vendime të plotfuqishme dënimi;
 - certifikatë se nuk ekzistojnë të dhëna të shqiptuara për sanksion të shqiptuar për kundërvajtje që përbën ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - vërtetim mjekësor me të cilën do të dëshmohej se është psikofizikisht i shëndoshë;
 - Dëshmi për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet;
 - Dëshmi për posedim të certifikatës jo më të vjetër se 5 vjet për njohje të gjuhës angleze (TOEFL IBT) – së paku 30 pikë, (IELTS) – së paku 3 pikë, (BULATS) – së paku 20 pikë ose (KET) (Cambridge English) – të dhënë
 - program për punë për mandatin e ardhshëm 4 vjeçar.
 3. Afati për parashtrimin e dokumenteve zgjatë 8 (tetë) ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e publikimit të shpalljes publike.
 4. Me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet do të realizohet intervistë për çka do të informohen të njëjtit enkas.
 5. Paga bazë parashihet në pajtim me matjet dhe kriteret e përcaktuar me Marrëveshjen kolektive për arsim të mesëm dhe e njëjta është 26.056, 00 denarë.
 6. Orari i punës së drejtorit është prej ora 07:30 deri në ora 15:30, ndërsa orari javor është në kuadër të punës 40 orësh prej ditës së hënë deri ditën e premte.
 7. Vendi i punës drejtor në Shkollë është me autorizime të posaçme.
 8. Afati në të cilin do të zgjidhet drejtori është 45 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.
 9. Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuar a në noter. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen në Këshillin e shkollës përmes postës në adresën: SHMPK "Dimitrija Çupovski" nga Velesi, rr. "Bllago Gjorev" nr. 40 Veles ose personalisht në arkivin e shkollës me zarf të mbyllur me shenjë "për shpallje për drejtor". Informatat në tel. 043/232-541

Këshilli i shkollës pranë SHMPK "Dimitrija Çupovski" Veles
Kryetar:
Verka Jugova

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 167/2015), në pajtim me lajmërimin nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Shkup për pëlqime të miratuara për punësim nr. 12-1522/1 të datës 05.02.2018 dhe nr. 12-1488/2 të datës 13.02.2018, nenit 59 dhe nenit 60 të Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 44/1995 deri 67/2017) dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës dhe Vendimit të drejtorit të SHMK "Jovçe Tesliçkov" Veles publikohet:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të personelit teknik për kohë të pacaktuar dhe mësimdhënës për kohë të caktuar

1. Mirëmbajtës i higjienës me kohë të pacaktuar të punës me 40 (dyzet) orë pune në javë – 1 (një) realizues me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar me neto pagesë fillestare mujore prej 12.000,00 denarë, orari ditor i punës prej ora 6:00 deri në ora 14:00.
2. Mësimdhënës të Sportit dhe aktiviteteve sportive për kohë të caktuar të punës si zëvendësues për UD drejtorin deri më 31.08.2018 me fond të plotë të orëve 40 (dyzet) orë pune në javë – 1 (një) realizues, me studime të mbaruara (në pajtim me normativin për arsim të mesëm) PSP – shkalla VII/1, orari ditor i punës prej ora 07:30 deri në ora 13:30 (në pajtim me orarin e orëve mësimore), neto pagesa fillestare mujore prej 21.542,00 denarë.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e caktuara në dispozitat nga Ligji për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim të mesëm dhe të njohin gjuhën letrare dhe alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi:

- Të kenë arsim të përkatës për vendin e nevojshëm të punës dhe
- Të jetë shtetas i R. Maqedonisë.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:

- Kandidatët nga pika 1:**
- Biografi
 - Dëftesë ose diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (original ose kopje të vërtetuar në noter),
 - Certifikatë të shtetësisë së R. Maqedonisë.
- Kandidatët nga pika 2.**
- Biografi
 - Diplomë për arsim të mbaruar shkalla VII/1 (original ose kopje të vërtetuar në noter).
 - Certifikatë për përfitjet të arritura pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucionet e akredituara për arsim sipëror nëse kandidati nuk ka drejtim mësimor,
 - Certifikatë të shtetësisë së R. Maqedonisë.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të afatit për paraqitje. Dokumentet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet e kompletuara të parashtrohen në Arkivin e SHMK "Jovçe Tesliçkov" Veles, në adresën rr. "Kukushka" nr. 37.
Tel. 043/231098

Në bazë të nenit 131 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për arsim sipëror të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM nr 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015 dhe 20/2015) dhe nenit 20 paragrafi 1 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" Manastir, Fakultetit i veterinarisë Manastir publikon

KONKURS

PËR ZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TITULL TITULLAR

Shpallet konkurs për zgjedhje të mësimdhënësit në titull titullar nga sferat në Shkencat matematiko-natyrore 10700 Kimi, 10703 Biokimi dhe 10714 të tjera.

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" Manastir.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrajnë: biografi të shkurtë, formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues (merret nga fakulteti), diplomë për shkallën shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet, dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme, certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e kandidatëve dorëzohen të rekomanduara përmes postës ose në arkivin e fakultetit në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit.

Fakulteti i veterinarisë Manastir

TETOVË, DHJETËRA VJEDHJE BRENDA FAMILJES

VJEDHJET E RREJSHME NË MODË NË TETOVË



Paditet drejtori i RTVM-së

Shkup, 25 shkurt - Kallëzim penal për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit është dorëzuar kundër drejtorit të Radio Televizionit të Maqedonisë, Marjan Cvetkovski, i cili në vitin 2016 ka firmosur marrëveshje me firmën "Analitika" për matje elektronike të TV auditoriumit me pipëlmetra në territorin e Maqedonisë. Përveç për drejtorin e RTVM-së, kallëzim penal është dorëzuar edhe për G.S. (56) i cili ka qenë përfaqësues i firmës "Analitika". Nga MPB-ja shpjegojnë se Cvetkovski, edhe krahas vërejtjeve nga Komisioni për furnizime publike të RTVM-së se duhet të pranohet çmimi i zvogëluar mujor për njësi prej 87.637 denarë që e ka ofruar "Analitika" në vend të çmimit fillestar mujor për njësi prej 175.000 denarë, megjithatë ka lidhur marrëveshje për furnizim publik të shërbimeve në vlerë të përgjithshme prej 2.100.000 denarë pa TVSH të përllogaritur, gjegjësisht 175.000 denarë çmim mujor për njësi pa TVSH të përllogaritur. "M.C. dhe G.S. më 29.07.2016 kanë firmosur 'Marrëveshje kornizë për furnizim publik të shërbimeve' me vlerë të përgjithshme të së njëjtës prej 2.100.000 denarë pa TVSH të përllogaritur gjegjësisht 175.000 denarë çmim mujor për njësi pa TVSH të përllogaritur, edhe pse e kanë ditur se në pajtueshmëri të çmimit të fundit të arritur në ankand duhej të firmosej në vlerë prej 1.051.650 denarë pa TVSH të përllogaritur për 12 muaj ose 87.637,50 denarë çmim mujor për njësi pa TVSH të përllogaritur", thuhet në njoftim. Me këtë që të dytë e kanë dëmtuar buxhetin e RTVM-së në vlerë të përgjithshme prej 1.237.053 denarë me TVSH të përllogaritur, ndërsa nga ana tjetër kanë siguruar dobi pronësore kundërligjore për "Analitika"-n në vlerë prej 1.048.350 denarë. (O.Xh)



Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë u bën me dije qytetarëve se paraqitja e rrejshme është vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg nga tre muaj deri në tre vite

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 25 shkurt - Në rajonin më të gjerë të Tetovës, vitin e kaluar dhe në fillim të këtij viti janë regjistruar dhjetëra vjedhje brenda familjeve, si në fshatin Bogovinë, Urviç, Tudencë, ku janë vjedhur flori, para..., ndërsa kanë qenë të involvuar anëtarë të familjes apo të afërm të tyre. Kryerësit e këtyre vjedhjeve në mënyrë të përkryer kanë vjedhur gjëra të çmuara duke mos lënë pas tyre asnjë gjurmë, ndërsa në anën tjetër pronarët i paraqesin këto vjedhje. Policia e Tetovës një pjesë të madhe të këtyre rasteve i ka zbardhur plotësisht duke bërë fletëparaqitje adekuate. Po ashtu, nga policia theksojnë se ka vjedhje të inskenuara nga vet pronarët, prandaj edhe rikujtojnë se edhe vjedhjet e rreme paraqesin vepër penale. Derisa në vjedhjet e vërteta, policia thotë se hajnat zakonisht kanë informata paraprake se në shtëpi nuk ndodhet askush. "Shfrytëzojnë njerëz të afërm, të cilët

njohin terrenin dhe më pas kryejnë vjedhjen. Kjo e bën më të vështirë kapjen e tyre në vendngjarje. Zakonisht vjedhjet janë kryer gjatë orëve të natës kur familjarët janë në gjumë ose nuk kanë qenë në shtëpi. Këtë më së miri e shfrytëzojnë hajnat dhe shumë lehtë e kryejnë vjedhjen pa u hetuar dhe pa lënë gjurmë. Po ashtu, në fshatrat malor ku shumica e banorëve janë shpërngulur, por kanë shtëpiza të vogla banimi, atje vidhet më lehtë dhe nuk hetohen nga askush dhe policia e ka më vështirë për ti gjetur. Në ato shtëpiza vidhen sende prej metaleve të ndryshme dhe hekur, kurse pastaj shiten në treg me çmim të lartë", tha zëdhënësi i policisë në Tetovë, Marijan Josifovski. Në ndërkohë, Josifovski thotë se shumë individë shpeshherë dinë edhe të sajojnë vjedhjet, pasi paraprakisht i shesin telefonat dhe gjësendet e tjera për të mbuluar borxhe të caktuara, dhe më pas i denoncojnë se të njëjtat u janë vjedhur. "Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë apelon, veçanërisht deri tek të rinjtë, që të mos i lënë telefonat celularë, syzet e diellit, dhe gjësendet e tjera me vlerë në tavolina të kafiterive, në diskoteta, ose në tarraca të hapura dhe të largohen për një kohë të gjatë. Për arsye se kjo është një mundësi shumë e favorshme për

vjedhësit, të cilët veprojnë shpejtë, pa u vërejtur nga askush i marrin këto gjësende dhe shpejtë largohen nga vendi i ngjarjes", deklaroi Josifovski. Atyre të cilët kanë mundësi financiare u këshillohet që të furnizohen me pajisje adekuate mbrojtëse, sidomos nëse me ditë apo me muaj të tërë nuk janë në objekte. "Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë ka ndërmarrë masa intensive për zbardhjen e vjedhjeve dhe apelon tek pronarët e shtëpive që në mënyrë kualitative të sigurojnë të njëjtat sidomos nëse nuk janë në shtëpi, por edhe të mos lënë në vende të ekspozuara sendet me vlerë. Sepse, hajnat në mënyrë të shkathtë shfrytëzojnë çdo rast sidomos nëse dyert nuk janë të mbyllura apo janë dyer jo kualitative për të vepruar", deklaroi Josifovski. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë u bën me dije qytetarëve se paraqitja e rrejshme është vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg nga tre muaj deri në tre vite, por edhe thirrja e rrejshme në polici është kundërvajtje që mund të sanksionohet me gjobë prej 100 deri në 400 euro. Sipas statistikave, gjatë vitit 2016 në rajonin që e mbulon Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, gjithsej janë regjistruar 638 vjedhje të rënda dhe 324 vjedhje të tjera.

REAGIM I LËVIZJES BESA

Vazhdon diskriminimi i kulturës shqiptare

Shkup, 25 shkurt - Programi vjetor për mbështetjen (më saktë: diskriminimi) i kulturës i Ministrisë së Kulturës edhe një herë e konfirmoi se mjetet që për vite me radhë është dashur t'u ndahen artistëve, shtëpive botuese, festivaleve e punonjësve të artit, promovimeve të traditës, artit, librit e

kulturës shqiptare, ende vazhdojnë të përfundojnë në xhepat e familjarëve të funksionarëve të qeverisë. kështu thuhet në reagimin e Lëvizjes BESA, sipas të cilës, "kjo praktikë e thellon edhe më tepër diskriminimin e kulturës shqiptare, e cila pos diskriminimit nga ana e sistemit shtetëror, vazh-

don të diskriminohet edhe nga ana e funksionarëve të pangopur shqiptarë".

"Për fat të keq, sot po vërtetohen paralajmërimet tona se nuk mund të kemi qeveri reformatore me elementet e trashëguara kriminogjene nga qeveria e kaluar. Ku ta dimë, mbase edhe

qeveritarët e rinj për model funksionimi i kanë marrë funksionarët e korruptuar të regjimit të kaluar, disa prej të cilëve i kanë kolegë! Prandaj i inkurajojmë organet e drejtësisë për hetimin e korrupsionit dhe urgjentisht të marrin masa, duke e sanksionuar maksimalisht këtë praktikë famëkeqe,

ndërsa ministri i Kulturës, nëse dëshiron të dëshmojë se dallohet nga ish ministrat e Kulturës, do të duhet ta anulojë këtë program dhe të kërkojë ndjesë që dikush ka ndërhyrë përsëri për diskriminimin e kulturës shqiptare", thuhet në reagimin e Lëvizjes BESA.

Parlamenti izolues

Nga

Musa SABEDINI



Më herët, krejt këtë punë të mbrapshtë dhe të pa shije që po e bënë Parlamentin dhe deputetët e saj e kisha quajtur "Parlament terrorizues" dhe këtë e kisha argumentuar. Kurse tani po e quaj "Parlament izolues". Këto dy epitete, ky Parlament dhe këta deputetë i kanë fituar nga fakti se këta ligjvënës e bënë horë një Kosovë, na bënë horë edhe neve para botës, me pamje aq të vrazhda, duke përdorë edhe gaz lotsjellës brenda, skena këto që terrorizojnë qytetarinë e një vendi. I njëjti Parlament dhe të njëjtit deputetë, tani për shkak të interesave kryekëput personale dhe kurrë kombëtare apo shtetërore, tallen me ne, me Kosovën dhe popullin.

Ata me vetëdije e duan izolimin e Kosovës nga Evropa, duan që Kosova të stagnojë. Nga "Parlamenti izolues" qytetarët e Kosovës nuk mund të presin asnjë mrekulli, madje nuk mund të presin as që një deputet si këta t'i kryejnë obligimet minimale ndaj vullnetit qytetar. Paramendoni se në çfarë sikleti e ka sjellë Kosovën kjo strukturë dhe paramendoni që nesër, ose shumë afër, duhet të bisedohet me Serbinë për vijën kufitare në Karaçevë dhe Zahiraj, në pjesën lindore të Kosovës dhe prej këtyre deputetëve pritet të ratifikojnë marrëveshjen. Mali i Zi u tregua i drejtë me Kosovën, e asesi me politikanët tanë, kur lëshoi pe, ose kur na dha një mundësi për të ecur përpara. Për një raport të Bulliqit, që tashmë të gjithë e dimë se ishte raport politik dhe jo profesional, synohet me vetëdije izolimi i Kosovës. Ne, edhe ashtu jemi të izoluar dhe të humbur në raport me Evropën, por të paktën gjërat që varen nga ne dhe që nuk janë të imponuara nga të tjerët, duhet t'i kryejmë pa shtyrje e pa ndërhyrje.

S'kam pritur e as nuk kam besuar që Ramush Haradinaj të tregohet kaq naiv në vendimmarrje. Ramushi praktikisht po e pranon fundosjen e tij në qeverisje. Kur je i pari të ka hije edhe të merresh vesh me shumicën dhe, edhe të lëshosh pe kur është në pyetje interesi i përgjithshëm i vendit. Me këtë stil të të punuarit dhe sidomos me kulturën e ulët politike të treguar në foltoren e Kuvendit, Ramush Haradinaj, nuk mund të përfitojë asgjë, përkundrazi vetëm sa mund të pësojë humbje të autoritetit në publik. Kosova dhe klasa politike e saj nuk e kanë idenë se çfarë na pret në të



S'kam pritur e as nuk kam besuar që Ramush Haradinaj të tregohet kaq naiv në vendimmarrje. Ramushi praktikisht po e pranon fundosjen e tij në qeverisje. Kur je i pari të ka hije edhe të merresh vesh me shumicën dhe, edhe të lëshosh pe kur është në pyetje interesi i përgjithshëm i vendit

ardhmen evropiane, sa detyra duhet të kryhen e sa obligime janë para nesh si shoqëri. Është koha e fundit që ky Parlament, që me vetëdije po çon Kosovën nga izolimi i mëtejshëm, ta ratifikojnë demarkacionin dhe të mos mbetemi peng të njerëzve analfabet e përrallëtarë.

Kosova nuk ka nevojë për ndarje e as për paragjykimet e sulme të ulëta. Të gjithë e duan Kosovën njëjtë, ama këto ditët e fundit do të jenë më të rëndat dhe më vendimtare për ne dhe për të gjithë ata që po mundohen për të na korrigjuar në gabimet tona trashanike. Kosova


Dëshpërimi nga kjo klasë politike ka nisur kaherë dhe, dorën në zemër, nuk janë të gjithë të pazot e të paditur, sepse ka prej tyre që meritojnë respekt për angazhimin që bëjnë, por fatkeqësisht 70 për qind të tjerët janë të paaftë e të dobët në shumë nivele e fusha



nuk duhet të udhëhiqet nga Kanuni, e as nga odat e nga çiftelitetë e ahengjet e natës. Kosova pret ta krijojë një ushtri të politikanëve që logjikojnë me kokën e tyre dhe që vendimet i marrin mbi bazën e interesave të popullit që i ka votuar dhe që pret prej tyre. E përmenda qëllimisht Karaçevën dhe Zahirajt, sepse janë dy fshatra kufitare që pritet të debatohen gjatë demarkacionit me Serbinë. Paramendoni se si do të sillen ky Parlament e këta deputetë të papërgatitur totalisht përballë këtij kontesti shumë më specifik e më delikat se Qarkori e Zhlebi. Policia serbe, legalisht shkel tokën e Kosovës dhe asnjëherë Qeveria apo Parlamenti ynë nuk kanë diskutuar për këtë problem. Mos të flas për Zahirajt, një lagje e humbur pas luftës, një fshat i vogël, por me shumë pasuri nëntokësore. Serbia nuk e ka lëvizur rastësisht kufirin në këtë pjesë. Dëshpërimi nga kjo klasë politike ka nisur kaherë dhe, dorën në zemër, nuk janë të gjithë të pazot e të paditur, sepse ka prej tyre që meritojnë respekt për angazhimin që bëjnë, por fatkeqësisht 70 për qind të tjerët janë të paaftë e të dobët në shumë nivele e fusha.

(zëri.info)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 25 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Skrinuar i qëndron besnik Interit

Është në sezonin e tij të parë si zikaltër, por Milan Skriniar është shndërruar në një nga lojtarët më të rëndësishëm të Interit, duke tërhequr edhe vëmendjen e klubeve të mëdha. Pas ndeshjes së fituar ndaj Beneventos, ku lojtari sllovak shënoi golin e parë, Skriniar përsëriti se nuk ka ndërmend të largohet nga Interi dhe se e shikon veten për shumë vite në këtë ekip. 23-vjeçari tha se ndihet mirë me skuadrën, tifozët dhe drejtuesit dhe se dëshira e tij e vetme është të arrijë objektivat sezonale me zikaltërit, veçanërisht renditjen në zonën Champions.



LIGA E PARË, JAVA E 21

HASANI HERO I KUQEZINJVE, KHAN SHPËTON SHKUPIN NGA DISFATA

Ndeshjet e Ligës së parë të javës së 21 u zhvilluan në kushte të rënda pas të reshurave të mëdha të borës në qytetet e Maqedonisë, respektivisht në Kratovë ku nuk u luajt futbolli, pastaj në Tetovë dhe Manastir si dhe në stadiumin në "Hekuran". Por, pa marr parasysh kësaj, në tre terrenet tona u luajtën ndeshjet e javës së 21 dhe ku nuk munguan emocionet

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 25 shkurt - Pobeda dhe Shkupi kanë zhvilluar një ndeshje të "çmendur" në të cilën u shënuan gjashtë gola, një penallti humbën bardhekaltërit, ndërsa u tregua edhe një karton i kuq, derisa ndeshja u zhvillua në kushte jashtëzakonisht të rënda, ku fusha ishte e mbuluar me borë. Edhe pse Shkupi me anë të Tipuriq dhe Adem kishte epërsi prej 0-2, nikoqirët nuk u dorëzuan dhe me golat e Najdovskit dhe në dy herë Geshovskit përmbysën rezultatin në 3-2. Për një pikë për FC Shkupi u përkujdes turku Emre Khan. Ndryshe me këtë barazim Shkupi zbrit në pozitën e pestë me gjithsej 26-të pikë, ndërsa Pobeda gjendet në pozitën e nëntë me 20-të pikë.

Sa i përket ndeshjes, pjesën e parë Shkupi e filloi furishëm dhe për vetëm shtatë minuta krijuan epërsi prej dy golave. Fillimisht Tipuriq, i cili debutoi në këtë ndeshje për Shkupin, shfrytëzoi një pakujdesi të mbrojtjes nikoqire pas rivënies nga këndi duke mposhtur portierin Tofillovski. Dy minuta më vonë, pas një aksioni mirë të organizuar, Ermedin Adem shënoi një gol të bukur nga pothuajse 20-të metra. I njëjti futbollist pesë minuta më vonë nuk realizoi nga pika e bardhë, duke humbur një mundësi të mirë për të rritur epërsinë në 0-3.



REZULTATET:	
RABOTNIČKI – VARDARI	2-1
POBEDA – SHKUPI	3-3
SHKËNDIJA – A. PANDEV	1-0
SKOPJE – RENOVA	1-1
SILEKSI – PELISTERI	(NUKU LUAJT)

Në anën tjetër, nikoqirët me anë të një penalltie në minutën e 43 të cilin e realizoi Najdovski, rikthyen shpresat duke shënuar për 1-2. Me këtë rezultat përfundoi pjesa e parë, ku Shkupi dominoi plotësisht si me lojë poashtu edhe me raste.

Pjesa e dytë ishte jashtëzakonisht interesante. Fillimisht Pobeda

nëpërmjet sulmuesit Geshovski, i cili hyri në pjesën e dytë pas vetëm shtatë minuta lojë (52') barazoi rezultatin në 2-2. Për tu bërë gjërat më të rënda për skuadrën e Shkupit, ishte kartoni i dytë i verdhë për Adem në minutën e 58-të. Epërsinë e një lojtari më shumë në fushë e shfrytëzuan nikoqirët duke marr

iniciativën në fushë dhe në minutën e 77-të përsëri përmes Geshovskit përmbys rezultatin në 3-2. Me këtë gol mendohej se Shkupi nuk do të jetë në gjendje të barazojë rezultatin, por kështu nuk mendoj edhe turku Emre Khan, i cili debutoi gjithashtu në këtë ndeshje. Zhvillohej minuta e 88-të kur Khan mori

një top të mrekullueshëm nga gjysma e fushës nga Broja, doli sy me sy me portierin Geshovski, dhe me një gjuajtje precize shënoi për 3-3. Njëherit me këtë rezultat përfundoi edhe ky takim, në të cilin u shënuan gjashtë gola, derisa u dha një karton i kuq dhe një penallti e humbur.

Lideri aktual Shkëndija nuk lejoi befasi dhe me rezultatin minimal 1-0 mundi Akademija Pandevin. Edhe në këtë ndeshje kishte befasi, pasi kuqezinjtë humbën dy penallti, fillimisht kapiten Hasani dhe më pas sulmuesi Besart Ibrahim. Por, në fund nëpërmjet kapitenit Ferhan Hasani, djemtë e trajnerit Qatip Osmani shënuan fitore dhe njëkohësisht arritën të shkëputen nga konkurenti i tyre i vetëm Vardar në plot 11-të pikë. Cekim, kuqezinjtë këtë ndeshje nga minuta e 21 luajtën me një futbollist më pak, pasi Fazllagiq pas një ndërhyrje të rëndë ndaj Gancev, u ndëshkua direkt me karton të kuq. Skopje dhe Renova kanë luajtur baras 1-1, gjithashtu në një terren të vështirë për lojë. Të parët në epërsi kaluan nikoqirët me golin e Bopesu në minutën e 77, ndërsa në minutën e 90-të Neziri i sollti një pikë të madhe bardhekaltërve nga Tetova. Ndërkohë, skuadra e Sileksit dhe Pelisterit nuk e zhvilluan ndeshjen e tyre, pas kushteve të rënda për lojë në stadiumin në Kratovë. Në Kratovë pa ndërpresë ka pasur të reshura të mëdha të borës, me çka nuk ka pasur kushte për lojë në stadiumin e këtij qyteti. Vendimin për anulimin e ndeshjes u soll pas konsultimeve me kapitenët dhe referin Josip Barton. Të shtunën, kampioni aktual Vardari, u mund nga Rabotnički me 2-1.



Latifi fiton duelin ndaj OSP

Sportisti shqiptar i arteve marcialle Ilir Latifi, por që garon për Suedinë, mposhti me "submission" në raundin e parë rivalin e tij amerikan Ovince Saint Preuks (OSP), në duelin e vlefshëm për "UFC on Fox", zhvilluar në Florida. Një fitore e merituar e Latifi, 14 fitore, 5 humbje dhe 1 ndeshje pa rezultat, që tashmë ia afrohet një dueli për titull në peshën "light heavyweight". Latifi e dominoi sfidën, e cila pritej të ishte më

spektakolare, por shqiptari bëri një paraqitje të shkëlqyer, duke e goditur me këmbë që në start rivalin amerikan. Edhe pse OSP përpiqej të mbrohej, nuk i rezistoi dot një të majte të fuqishme të Latifi, duke u rrëzuar në tapet.

Shqiptari kap nga qafa rivalin amerikan, që nuk ka më fuqi dhe dorëzohet, ndërsa Latifi nis festën, i vetëdijshëm se tashmë e pret një sfidë edhe më e madhe.

ENNUR TOTRE, FUTBOLLIST

FITIMI I TITULLIT DO TË JETË REALIZIMI I NJË ËNDRRE TJETËR



“Ka qenë pasion dhe dëshirë e madhe e babait tim që të merrem me futboll dhe pikërisht ai më ka regjistruar që në moshë shumë të re. Mbase kanë parë edhe talentin tim për këtë sport që i ka shtyrë të insistojnë në këtë drejtim që në moshën fëmijërore.”, kështu e fillon rrëfimin e tij 21 vjeçari

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 25 shkurt - Ishte viti 2015 kur në moshën 18-të vjeçare firmosi kontratë profesionale për KF Shkëndija nga Tetova, duke u bërë kështu zbulimi më i madh i kuqezinjve, derisa më pas u promovua edhe si futbollist i skuadrës së parë. Prej atëherë ai është pjesë e ekipit të parë dhe njëri prej futbollistëve më perspektiv të ekipit kuqezij. Fjala është njërin prej futbollistëve më të talentuar në vendin tonë, Ennur Totre. Ai për gazetën KOHA, rrëfen fillimet e para me sportin e futbollit, arrijtet e tij me KF Shkëndija, ftesa për tu bërë pjesë e ekipit të parë, ftesa për Kombëtaren e Shqipërisë dhe synimet e tija në të ardhmen. “Ka qenë pasion dhe dëshirë e madhe e babait tim që të merrem me futboll dhe pikërisht ai më ka regjistruar që në moshë shumë të re. Mbase kanë parë edhe talentin tim

për këtë sport që i ka shtyrë të insistojnë të më kanalizojnë në këtë drejtim që në moshën fëmijërore.”, kështu e fillon rrëfimin e tij 21 vjeçari.

PREJ FILLIMIT TE KF SHKËNDIJA

Ndryshe, Totre rrjedh nga Akademia e KF Shkëndija, ku i ka kaluar të gjitha kategoritë, derisa nuk kanë munguar edhe sukseset. “I kam kaluar gjithë kategoritë e reja të Shkëndijës deri te ekipi i parë. T’ju them të drejtën jam krenar për këtë, pasi ëndërr e çdo fëmije kur nis të ushtrojë në një klub është që një ditë të provojë ekipin senior. Duke parë si kanë shkuar gjërat gjatë gjithë periudhës në grupmoshat e reja, duhet të jem falënderues ndaj gjithë atyre që kanë punuar me mua brenda këtyre viteve në secilën kategori. Jam mirënjohës për klubin dhe trajnerët e akademisë, pasi secili ka meritën dhe kontributin e tij në ndërtimin tim si futbollist. Kam pasur fat që këtë periudhë Shkëndija u morr në menaxhim të kompanisë ‘Ecolog’ dhe gjërat kanë shkuar duke u përmirësuar secilin vit që ka kaluar, duke arritur sot në një nivel që është model për shumë klube edhe pse ka edhe shumë hapësirë për të arritur atë që duhet të jetë. Vitet që kam luajtur me kategoritë e reja kemi qenë gjithmonë konkurrent për titull, por unë s’pata fatin të dalim kampion ashtu si ndodhi vitin e kaluar me gjeneratën U19. Dua të potencoj se kam qenë me fat që jam grumbulluar me ekipin e parë prej kur isha pjesë e ekipit të kadetëve si 16-të vjeçar që ishte privilegj i madh për mua dhe familjen”, shtoi Totre.

FTESA NË EKIPIN E PARË, REALIZIMI I ËNDRRËS

Pasi u kishte rënë në sy drejtuesve të klubit, 21 vjeçari merr ftesë për tu bërë pjesë e ekipit të parë, ndërsa më pas erdh edhe debutimi. Sigurisht se kjo e ka bërë të lumtur Ennurin ku emocionet kanë qenë të mëdha. “Ishte privilegj i madh të grumbullohem me ekipin e parë pa arritur ende të jem pjesë e juniorëve dhe këtu ishte realizimi i ëndrrës së parë. Emocion dhe kënaqësi apo thjesht ndjenja të përziera me atë që po ndodhte. Për herë të parë në një ndeshje zyrtare kam debutuar në nëntor të vitit 2014 kundër Pelisterit kur u inkuadrova si zëvendësues. Ndjenjë e bukur dhe e papërshtueshme. Ndërkohë, afirmimin e vërtetë me seniorët e morra falë besimit që kishin te unë trajneri i atëhershëm Jeton Beqiri dhe drejtori sportiv Nebi Mustafa. Ishte prill i vitit 2015 dhe klubi ishte në krizë rezultatesh. Përballeshim me Vardarin në Kumanovë dhe ishte e pabesueshme kur më thanë se do nisja ndeshjen nga minuta e parë. Fituam 3:2 një takim të rëndë kur ne herët mbetëm me 10-të lojtarë pas përjashtimit me të kuq të një bashkëlojtari. Këtu filloi karriera ime e vërtetë me ekipin e parë”, tregon Totre.

SHQIPËRIA E FTON, POR NUK I BESON!

Ftesa për ekipin e parë, debutimi në një ndeshje zyrtare, nuk kanë qenë momentet e vetme që e kanë bërë të lumtur Totren. Ftesa



I kam kaluar gjithë kategoritë e reja të Shkëndijës deri te ekipi i parë. T’ju them të drejtën jam krenar për këtë, pasi ëndërr e çdo fëmije kur nis të ushtrojë në një klub është që një ditë të provojë ekipin senior. Duke parë si kanë shkuar gjërat gjatë gjithë periudhës në grupmoshat e reja, duhet të jem falënderues ndaj gjithë atyre që kanë punuar me mua brenda këtyre viteve në secilën kategori. Jam mirënjohës për klubin dhe trajnerët e akademisë, pasi secili ka meritën dhe kontributin e tij në ndërtimin tim si futbollist

për tu bërë pjesë e Kombëtares së Shqipërisë, ishte edhe një moment gëzimi, mirëpo e gjithë kjo nuk zgjati shumë, pasi drejtuesit e saj nuk ia dhanë rastin e duhur, që Ennuri të dëshmojë vlerat e tij edhe tek kombëtarja. “Në fakt unë jam pjesë e përfaqësueses U21 të Maqedonisë. Më ka ftuar Shqipëria dhe jam paraqitur njëherë në grumbullim, por të them të drejtën nuk më kanë konsideruar fare dhe jam kthyer i dëshpëruar. Pastaj jam paraqitur me Maqedoninë dhe si në klub ashtu në përfaqësuese mundohem gjithnjë të jap më të mirën për të arsyetuar besimin”.

TITULLI ME SHKËNDIJËN, REALIZIMI I ËNDRRËS

Në fund Totre ka folur edhe për synimet e tij me KF Shkëndija dhe karrierën e tij të mëtejme. “Për momentin e vetmja gjë që kam në mendje është sezoni aktual në të cilin me Shkëndijën kërkohet titullin e kampionit dhe trofeun e Kupës që do të jetë realizimi i një tjetër ëndërr. Jemi në rrugë të mbarë dhe besoj se do ia dalim. Pastaj të ardhmes nuk i dihet. Dua të përparoj sa më shumë që do të jetë e mundur me klubi tim amë, por edhe me transferim eventual jashtë vendit. Mund të them se ofertat nuk mungojnë, por besoj se deri tani nuk ka ardhur ende momenti i duhur për të bërë një hap të tillë. Do ja lëmë kohës, pasi tani fokusin e kam te sezoni aktual për të realizuar objektivat”, përfundoi Ennur Totre, mesfushori i talentuar i Shkëndijës.



ARRIN REKORDIN QË E BËN MË TË MIRË SE MESSI


RONALDO PËRTEJ KUFIJVE DHE HISTORISË



Një sulmues monstruoz me një statistikë barbare ndaj çdo sulmuesi tjetër, kurrë më parë e dëshmuar, për të qenë absolutisht golashënuesi më i mirë në historinë e La Liga

Kristiano Ronaldo shënoi të shtunën kundër Alavesit dy gola në fitoren e Real Madridit me rezultatin 4-0, për të arritur kuotën e 300 golave në La Liga. Që nga momenti kur u transferua në Spanjë, portugezi ka zhvilluar 285 ndeshje. Plot 9 sezone më vonë, mesatarja e tij e golave është plot 1.05 gola në ndeshje. Më shumë se një gol për ndeshje të luajtur. Një sulmues monstruoz me një statistikë barbare ndaj çdo sulmuesi tjetër, kurrë më parë e dëshmuar, për të qenë absolutisht golashënuesi më i mirë në historinë e La Liga. Madje yllit të Real Madridit i janë dashur 41 ndeshje më pak se rivali i tij, Messi, për të arritur në kuotën e 300 golave. Argentinasi ka arritur kuotën e 300 gola-

vetëm në ndeshjen e tij të 326, dhe aktualisht është i vetmi në klasifikimin e golashënuesve më të mirë të të gjitha kohërave në La Liga, që renditet para Ronaldos, me 368 gola në 406 ndeshje. Që nga mbërritja e tij në Spanjë, Ronaldo u ka shënuar golat e tij plot 31 skuadrave kundërshtarë të Real Madrid. Ai është i vetmi futbollist në historinë e Real Madrid që ka arritur shifrën e 300 golave në historinë e kompeticionit. Janë vetëm dy kundërshtarët e Real Madrid, me të cilët është përballur në kompeticionet kombëtare, por që nuk kanë provuar shijen e golave të Ronaldos, Leganes dhe Girona. Pavarësisht të gjitha fjalëve dhe kritikave, statistikave të Kristiano Ronaldos këtë sezon janë në nivelet më të larta. Pavarësisht të gjithave, në momentin e shënimit të golit të dytë këtë të shtunë ndaj Alaves, Ronaldo barazoi Leo Messin në kuotën e 28 golave në të gjitha kompeticionet e këtij viti, ndonëse ka luajtur 7 ndeshje më pak se argentinasi.



Një vit pezullim për Nasrin

Telashe për Samir Nasri. Sulmuesi që aktualisht është pa skuadër nuk do të mund të nënshkruajë për Las Palmas dhe për asnjë skuadër tjetër. Motivi? Francezi është pezulluar për doping pas disa injeksioneve të ndaluara vitaminash, të bëra në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në dhjetorin e vitit 2016, në periudhën kur militonte te Sevija. Në atë periudhë, mesfushori i kishte besuar një klinike të quajtur 'Drip Doctors'. Asaj kohe klinika pat pranuar: "E kemi nënshtruar Nasri ndaj një kure të 'Immunity IV Drip', përmes rrugëve venoze, për ta mbajtur të hidratuar përgjatë një sezoni shumë impenjativ te Sevija. Më datë 31 mars të vitit të kaluar, avokatët e Nasri kishin apeluar vendimin e pezullimit në Komisionin Disiplinor, të Etikës dhe Kontrollit të UEFA, por shërbeu vetëm për të ulur dënimin, nga dy në një vit. Sipas asaj që raporton media spanjolle "Marca", lajmi zyrtar pritet të publikohet të hënën.

Jam bashkëshortja e Ikkardit, gënjeshtarët do të paguajnë!

Vanda Nara hidhet në sulm. Pas zërave të shumtë në lidhje me një krizë në marrëdhënien me Mauro Ikkardi, bashkëshortja e sulmuesit të Interit ka përdorur rrjetin social "Twitter" për t'u mbrojtur. "Në kohët e fundit po dalin shumë gënjeshtër në lidhje me mua dhe familjen time", - shkruan shoqja e Mauro në profilin e saj. "Jam mamaja e pesë fëmijëve dhe bashkëshortja e Mauro. E kam lënë gjithçka në dorë të avokatit tim. Do të paguaj pasojat për gjërat e këqija që keni thënë". Ton i ashpër për të larguar çdo dyshim një herë e për gjithmonë dhe për t'u përgjigjur atyre që në periudhën e fundit kishin vënë në dyshim marrëdhënien me Ikkardi. Argentinasi ka marrë një pozicion shumë të qartë. "Duhet ta dini që bëj një jetë krejtësisht normale. Punoj dhe merrem me fëmijët e mi, - ka përsëritur Vanda, - Ju merruni me jetën tuaj në vend që të shkruani gjëra të pavërteta për mua. Faleminderit!", ka shkruar Vanda Nara në "Twitter".



SIPAS MINISTRIT SAUDIT I SPORTIT, AL-ASHEIKH

Katari mund ta humb të drejtën e organizimit të botërorit

Në fillim të dhjetorit të vitit 2010, FIFA kishte marrë vendim që Katari të jetë organizator i Kupës së Botës së vitit 2022. Në sfond ishte spekuluar gjerësisht se zyrtarët e organizatës më të madhe botërore të futbollit të jetë korruptuar gjersa lulëzuan edhe shumë teori të konspiracionit rreth kësaj teme. Megjithatë, prokuroria zvicerane asnjëherë nuk arriti të argumentoi se Katarit kishte blerë organizimin e botërorit. Megjithatë, mediat gjermane kanë bërë të ditur se Kupa e Botës është e mundshme që mos të mbahet në shtetin e Lindjes së Mesme. Kjo u konfirmua edhe nga Ministri i



Sportit i Arabisë Saudite, Al-Asheikh. Sipas këtij të fundit, "organet specifike të FIFA-s sërish po hetojnë procedurën e caktimit të organizatorit, sepse kanë rrjedhur informacione të reja që sugjerojnë se disa zyrtarë kishin marrë rryshfet". Vendimi përfundimtar rreth organizatorit të botërorit të vitit 2022 do të bëhet i ditur gjatë muajve të ardhshëm të verës. Shtetet e Bashkuara dhe Anglia janë të interesuara për organizimin e edicionit të 22-të të Kampionatit Botëror që do të mbahet në Katar, i cili planifikon ta mbajë nga 21 nëntori deri më 18 dhjetor 2022.

Shënova hat-trik, më kritikoi se humba tetë topa

Sulmuesi spanjoll Fernando Torres di shuam gjëra që kanë lidhje me teknikat e duhura për të motivuar lojtarët, duke parë se ai ka punuar me disa prej trajnerëve më të mirë të botës gjatë karrierës së tij. Ai ka thënë se Rafa Benitez dhe Luis Aragones kanë arritur të marrin maksimumin nga ai me natyrën e tyre kërkuese. Torres ka qenë i suksesshëm nën drejtimin e Rafa dhe ka fituar Euro 2008 me Aragones.

"Mbah mend se po luaja shumë mirë, sapo kisha realizuar tre gola dhe të gjithë shkruajtën diçka sipër topit", ka thënë Torres duke kujtuar një ndeshje me Liverpul. "Të gjithë shkruan 'je më i miri' ose 'komplimentë', gjëra të tilla. Ndërsa mesazhi i Rafas ishte 'ke humbur tetë herë topin sot'. Ishte

mënyra që kishte ai për të të motivuar", pohon Torres.

Aragones ka qenë ndoshta trajneri që e njihte më mirë, edhe pse ka punuar me të qëkur Torres ka qenë një fëmijë. "Luis ka vështirësuar jetën, kërkonte shumë", ka zbuluar sulmuesi spanjoll. "Më ka lënë në stol, më ka bërë të stërvitem vetëm. Në ato momente mendon, 'ky do të më çmendë, do të më dëmtojë', por me kalimin e kohës e kupton sa të rëndësishme ishin ato gjëra. Jemi bashkuar përsëri disa vite më vonë dhe kemi luajtur finalen e Evropianit. Ai më mori veçmas dhe më tha 'Sot është momenti ynë, ti do të shënosh një gol dhe ne do të jemi kampionë të Evropës'. Pas këtij momenti kujton kohën kur ai të linte 30 mi-



nuta në fushë për të praktikuar kontrollin e topit ose gjuajtjen. Kujton personin që besoi tek ty në momentin më të rëndësishëm", ka thënë Torres.



REINA NË VEND TË DONNARUMMAS

Duke parë se nuk ka asnjë shans ta mbajë portierin e talentuar, drejtuesit e klubit kuqezi kanë nisur që tani të kërkojnë për zëvendësuesin dhe ai është portieri i Napolit, Pepe Reina, që do të vijë në Milano me koston "zero", pasi i përfundon kontrata në fund të këtij sezoni

Duket se aventura e portierit Gijgi Donnarumma te skuadra e Milanit është drejt fundit, një "martesë" e sforcuar dhe e destinuar të mbarojë në fund të këtij sezoni. E përditshmja italiane "Gazzetta Dello Sport" ka bërë me dije se portieri 19-vjeçar do të lërë kuqezinjtë për të luajtur në një ekip tjetër të madh, që luan në Çampions dhe ka ambicie të mëdha. Duke parë se nuk ka asnjë shans ta mbajë portierin e talentuar, drejtuesit e klubit kuqezi kanë nisur që tani të kërkojnë për zëvendësuesin dhe ai është portieri i Napolit, Pepe Reina, që do të vijë në Milano me koston "zero", pasi i përfundon kontrata në fund të këtij sezoni. Klubet kanë nisur që tani të bisedojnë

edhe pse marrëveshja duhet të arrihet me portierin, që në fund të këtij sezoni nuk do të ketë asnjë detyrim karshi Napolit dhe është i lirë të largohet. Reina është një portier me përvojë dhe që ofron garanci për kuqezinjtë, që po monitorojnë nga afër situatën, duke qenë se ai nuk ka asnjë klauzolë që ta lidhë me Napolin përtej kontratës. Portieri Pepe Reina u përfol se do të largohet nga ekipi i Sarrit që verën e kaluar, por në fund qëndroi. Tashmë ai sheh se ka një mundësi të artë të luajë në një tjetër klub të madh në moshën 35-vjeçare, ndërkohë që Donnarumma, sot do të festojë 19-vjetorin e lindjes, duke menduar se mund të fitojë më shumë parë dhe trofe në të ardhmen.

NËSE JUNAJTED HEQ DORË NGA POGBA

Raiola ka gati "Planin B"


Mesfushori francez Pol Pogba mund të largohet që në verën e ardhshme nga Manchester Junajted nëse marrëdhënia e tij me trajnerin Hoze Murinjo do të vazhdojë të jetë e tendosur, siç ka qenë javët e fundit. Lojtari i kushtoi 105 milionë euro "djajve të kuq" dy vite më parë (erdhi nga Juventus), por duket se "muaji i mjaltit" ka përfunduar dhe divorci është shumë pranë. Duke parë situatën e krijuar, në lëvizje për të sistemuar gjërat është vënë menaxheri i tij Mino Raiola, që po lëviz gurët për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për Pogba. E përditshmja britanike "The Sun" shprehet se Raiola ka nisur bisedimet me drejtuesit e Real Madridit për të transferuar aty Pogban verën e ardhshme edhe pse Pogba ka një klauzolë me vlerën e 60 milionë eurove. Burime nga klubi i Junajted shprehen se Pogba e ka bërë të qartë se nuk do të qëndrojë më atë, për sa kohë do të jetë edhe Murinjo. Por trajneri portugez ka një kontratë me Junajtedin deri në vitin 2020, ndaj vështirë se mund të largohet. Ndaj, largimi i francezit duket i paevitueshëm, pasi tashmë nuk e ka të sigurt edhe një vend si titullar te skuadra.

"Blindon" Verratti, cakton çmimin për Silvan



Paris Sen Zhermeni nuk heq dorë nga Marco Verratti. Sipas asaj që ka shkruar gazeta franceze "L'Equipe", klubi parisien vazhdon të refuzojë ofertat e Barcelonës për të marrë mesfushorin italian. Ashtu si ndodhi në verën e kaluar, klubi francez i ka thënë "jo" dëshirës së katalanasve për të nisur bisedimet për blerjen e Verrattit. Ndërkohë,

në fund të sezonit Tiago Silva mund të largohet nga Paris Sen Zhermeni. Sipas asaj që bën të ditur gazeta e lartpërmendur ka disa klube që janë interesuar për qendërmbrojtësin brazilian që ka përfunduar në stol dhe parisienët kërkojnë të paktën 15 milionë euro për futbollistin që blenë për 40 milionë euro nga Milan, katër vite më parë.



BEJLL REFUZON TRANSFERIMIN NË ANGLI

Dëshiron të luajë te Bajerni



Geret Bejll ka nisur një "luftë të ftohtë" me drejtuesit e Real Madridit, që kërkojnë ta përdorin si kartë për të sjellë në "Santiago Bernabeu" një emër të njohur sezonin e ardhshëm. Por sulmuesi nga Uellsit ka hedhur poshtë çdo përpjekje të skuadrës "merengues", duke preferuar të transferohet në Bundesligë dhe të luajë me fanellën e Bajernit Munihi. Lajmin e ka konfirmuar e përditshmja spanjolle "Don Balon", që i referohet burimeve nga klubi madrilien. Pre-

sidenti i Real Madrid, Florentino Perez, synon të sjellë në Madrid një emër të njohur sezonin tjetër, duke nisur nga Nejmar te Kane, nga Salah te Hazard dhe për ta realizuar këtë gjë shpreson të përdorë Bejllin si kartë për të balancuar ofertën. Por Bejll synon një të ardhme tjetër, të transferohet te Bajerni Munihi, duke u bërë zëvendësuesi i Arjen Robenit. Kjo situatë ka krijuar mjaft polemika te klubi spanjoll, ndaj Bejll është gjithnjë e më shumë pranë divorcit.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015), nenit 5 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të "M-NAV" SHA Shkup dhe Pëlqimit të marrë nga Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë nr. 18-2390/2 të datës 23.02.2018, "M-NAV" SHA Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE Për themelimin e marrëdhënies së punës

Për nevojën e punësimit të punëtorit për kohë të pacaktuar të punës për vendin e punës në vijim:

1. Këshilltar - 1 (një) realizues

Kandidati krahas fletëparaqitjes për punësim dhe biografisë së shkurtër (CV) duhet të dorëzojë dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme edhe atë:

- certifikatë të lindjes;
- certifikatë të shtetësisë;
- vërtetim për evidencë dënimi të dhënë nga gjykata kompetente;
- certifikatë për evidencë penale të dhënë nga gjykata kompetente;

Dokumentet e lartpërmendura duhet të parashtrihen në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme:

-Kandidati për vendin e punës – Këshilltar në Departamentin për resurse njerëzore: duhet të ketë të mbaruar ciklin e parë të studimeve – 180 kredi sipas SETK – diplomë universitare nga sfera e shkencave shoqërore. Është e nevojshme së paku 1 (një) vit përvojë pune. Kandidati duhet të dorëzojë diplomë ose certifikatë të fakultetit të mbaruar (original ose kopje të vërtetuara në noter) dhe vërtetim për përvojë të punës (listë nga SPIM). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale, e posaçërisht zotërim të aftësive të posaçme – punë me kompjuter.

Orët e punës gjatë javës 40, dita e punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:30 deri në ora 15:30, ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte. Neto pagesa bazë është: 41.273,00 denarë.

Dokumentet të dorëzohen në original ose kopje të vërtetuara në noter, në lokalet e "M-NAV" SHA Shkup në adresën rr. Makedonija nr. 25, objekti L Lazar Pop Trajkov, 1000 Shkup. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit të saj në mjetet e informimit. Në afat prej 3 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve, do të realizohet zgjedhja.

"M-NAV" SHA Shkup

AKTORËT QË RRËNUAN SIRINË

Në luftën e Sirisë janë përfshirë shumë vende të tjera - jo vetëm regjimi i Assadit dhe kundërshtarët e tij. Interesa të tyre kanë edhe Irani, Arabia Saudite, Rusia, SHBA...

IRANI: MBËSHTETËSI MË I MADH I ASSADIT

Regjimi jofetar i Sirisë dhe toekracia iraniane në parim nuk kanë shumë gjëra të përbashkëta. Por pikërisht Teherani e ka shpëtuar presidentin e Sirisë Baschar al-Assad nga rrëzimi. Të paktën deri në ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Rusisë në vjeshtën e vitit 2015, Irani ka qenë partneri më i rëndësishëm ushtarak i regjimit të Assadit. Teherani ka dërguar para, armë, informacione sekrete, këshilltarë ushtarakë dhe trupa në Siri. Ato trupa janë pjesë e Gardës Revolucionare, milicëve shiitë dhe Hezbollahit. Tëndosjet fetare i hapin hapësirë Iranit që të paraqitet atje si mbrojtës i shiitëve. Ndryshe aleanca e regjimit të Assadit me Iranin bazohet tek tri synime kryesore: dëshira për uljen e ndikimit amerikan në Lindjen e Mesme, dobësimin e Izraelit e më herët ka qenë edhe kufizimi i ndikimit të regjimit irakian në kohën e Saddam Husseinit. Ndërkohë të dy vendet janë edhe kundërshtarë të Arabisë Saudite. Në aspektin rajonal, Siria është për Iranin një hallkë e rëndësishme për lidhje me Libanin.

RUSIA: SHPËTIMI I ASSADIT

Kur Assadit ishte me shpatulla pas muri, ishte Rusia ajo që e shpëtoi. Rusia i nisi në 2015 aksionet ushtarake në mbështetje të regjimit të Assadit. Qëllimi zyrtar i Rusisë: lufta kundër terrorizmit. Faktikisht nuk është sulmuar vetëm "Shteti Islamik" (IS), por edhe shumë kundërshtarë të tjerë të Assadit.

Por Moska nuk është e interesuar vetëm për mbështetjen e Assadit. Pas izolimit të Rusisë për shkak të konfliktit në Ukrainë, presidenti Vladimir Putin ka dashur që ta rikthejë vendin e vet në skenën ndërkombëtare - dhe e arriti me sukses. Edhe Assadit ka përfituar nga kjo ndërhyrje.

Presidenti i Sirisë e ka rimarrë pushtetin në pjesën më të madhe të vendit. Rusia i ka arritur sukseset më të mëdha ushtarake në Aleppo dhe Palmyra. Por Kremli është kritikuar shpesh edhe për krime lufte ndaj civilëve në zonat e luftës.



ARABIA SAUDITE KUNDËRSHTARË E IRANIT

Arabia Saudite është shqetësuar për shkak të rritjes së influencës së Iranit në këtë rajon, që nga lufta e Irakut në vitin 2003. Riadi shqetësohet edhe për shkak të afërsisë me Damaskut dhe Teheranit. Prej fillimit të kryengritjeve në vitin 2011, Arabia Saudite ka mbështetur opozitën në Siri. Qëllimi: rrëzimi i Assadit dhe marrja e pushtetit nga opozita. Në këtë kuadër janë furnizuar me armë dhe para grupe të ndryshme xhihadiste.

FRANCA: MACRONI KËRKON ZGJIDHJE POLITIKE

Franca ka një rol të rëndësishëm atje. Fillimisht ka dërguar pajisje mjekësore për kryengritësit në Siri e më pas edhe armë. Në fund të shtatorit të vitit 2015, Franca ka zgjeruar sulmet ushtarake kundër trupave të IS, pas sulmeve terroriste në Paris, në nëntor të vitit 2015. Prioritetet e Francës në Siri, sipas pohimeve në Paris, janë përmirësimi i gjendjes humanitare në Siri, lufta kundër terrorizmit dhe rifillimi i negociatave të paqes. Presidenti Emmanuel Macron në veçanti angazhohet për këto negociata. Macroni vitin e kaluar ka shpallur se Franca nuk kërkon domosdoshmërisht rrëzimin e regjimit të Assadit për vazhdimin e negociatave paqësore. Para një jave presidenti francez ka kërcënuar me sulme ushtarake, në qoftë se dëshmohej se atje përdoren armë kimike kundër civilëve.

TURQIA: DIKUR MIK E TANI ARMIK

Turqia me veprimet e saja të njëanshme dhe në veçanti presidenti Recep Tayyip Erdogan, kanë pasur nga mesi i vitit 2000 raporte të shkëlqyeshme me regjimin e Assadit. Ata kanë publikuar madje edhe fotografi nga pushime të përbashkëta në Detin Mesdhe. Me shpërthimin e luftës qytetare në Siri, Turqia është pozicionuar kundër regjimit të Assadit dhe e ka mbështetur opozitën. Nëpër territorin e Turqisë kanë kaluar shumë armë dhe luftëtarë, që kanë shkuar në Siri, shpesh edhe

xhihadistë dhe luftëtarë të IS. Ndërkohë duket se Turqia duket se ka një qëllim kryesor - të evitojë krijimin e territoreve të lira kurde në zonën e afërt kufitare me Turqinë - ndonëse këtu është në konflikt me partnerin në NATO - SHBA. Përveç kësaj, Erdogani do që të ketë një fjalë vendimtare për rregullimin shtetëror të Sirisë pas luftës. Ky është një prej qëllimeve të ndërhyrjes ushtarake përtej kufirit. Projektionet turke kanë për qëllim që Turqia të bëhet një fuqi hegjemoniste në Lindjen e Mesme.



IZRAELI: ARMIKU GJENDET NË TEHERAN

Shqetësimi më i madh i Izraelit në luftën e Sirisë është prezenca e Gardës iraniane dhe milicëve të afërt me Teheranin në Siri. Izraeli ka frikë në radhë të parë se milicët e Hezbollahit do të pozicionohen dhe fuqizohen në Golan, në zonën kufitare mes Sirisë dhe Izraelit dhe prej atje mund të godasë territoret izraelite me raketa. Prej atje ndaj Izraelit janë nisur prej vitit 2011 rreth 100 sulme dhe ka pasur shumë autokolona me armë.

SHBA: PA PLAN

Mësimet nga dështimet e ndërhyrjes ushtarake në Irak dhe Libi, dhe hezitimet e ish-presidentit Barack Obama e kanë dobësuar pozitën amerikane në këtë rajon. Kur Assadit në vitin 2012 ishte buzë humbjes, Obama ka refuzuar një angazhim më të fuqishëm atje, ndonëse ka kritikuar ashpër sjelljen e Assadit. Në vend të SHBA ndërhyri Rusia dhe e mbështeti Assadin. Hezituese është edhe politika e Donald Trumpit. Qëllimet e tij janë shkatërrimi i IS dhe dobësimi i influencës së Iranit. Ndaj prezenca amerikane kufizohet në angazhimin e njësive speciale dhe disa sulme ajrore. Në këtë mënyrë SHBA është përfshirë në këtë luftë, pa pasur ndonjë rol vërtet të rëndësishëm. Ofensiva më e re turke kundër kurdeve ka shkaktuar dilema në SHBA, sepse Turqia është një partner i rëndësishëm në NATO. Uashingtoni njëkohësisht i sheh milicët kurde si partner të rëndësishëm në luftën kundër IS.

GJERMANIA: NDIHMAT

Qeveria gjermane ka theksuar në të kaluarën gjithnjë se angazhohet për një zgjidhje paqësore të konfliktit në Siri, por pa presidentin Assad. Së fundi zëdhënësi i qeverisë Steffen Seibert u ka bërë thirrje Rusisë dhe Iranit që të ushtrojnë ndikimin e tyre. "Pa mbështetjen e këtyre partnerëve, regjimi i Assadit nuk do të ishte atje ku është sot". Ushtarakisht Gjermania nuk është përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe nuk paraqet lojtar tepër të fuqishëm në rajon. Ndonëse avionët gjermanë mbështesin aksionet për zbulimin e pozicioneve të IS. Avionët gjermanë kanë fluturuar së pari nga Turqia, e pas tërheqjes së Bundesverit nga Incirliku, tani fluturojnë nga Jordania. Përveç kësaj Bundesverit mbështet në veri të Irakut kurdet, që luftojnë kundër IS. Gjermania ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë. Por së fundi ka pasur debate të shumta për shkak të dërgimit të tankeve gjermane Leopard në Turqi, të cilat përdoren tani nga Erdogani kundër kurdeve në Siri. (DW)

Haradinaj është pajtuar që raporti i Komisionit shtetëror për kufirin, të jetë vetëm informues dhe jo pjesë e pakos së Projektligjit për demarkacionin i cili, me gjasë, pritet të votohet të mërkurën

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka konfirmuar dakordimin e tij me versionin e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës për votimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Haradinaj, është pajtuar që raporti i Komisionit shtetëror për kufirin, të jetë vetëm informues dhe jo pjesë e pakos së Projektligjit për demarkacionin i cili, me gjasë, pritet të votohet të mërkurën. Krahas Projektligjit për demarkacionin, deputetët do të votojnë edhe për Deklaratën e nënshkruar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Malit të Zi, Filip Vujanović, përmes së cilës të dy presidentët zotohen për korrigjimin e gabimeve eventuale gjatë demarkacionit të kufirit mes dyja shteteve. "Unë kam bërë një lëvizje politike, sipas kërkesës së LDK-së, duke u dhënë mundësi deputetëve që të ecin përpara me marrëveshjen", ka thënë Haradinaj.

Këto komente, Haradinaj i bëri gjatë një konference të jashtëzakonshme për media, pasi që paprakisht partitë politike në koalicionin qeverisës, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma

ARRIHET MARRËVESHJA ME LDK-në PËR DEMARKACIONIN



për Kosovën dhe partia opozitare Lidhja Demokratike Kosovës, kanë arritur një konsensus për votimin e demarkacionit. "Kemi një ndryshim substancial. Kemi dakordim me LDK-në dhe pas kësaj besoj se janë krijuar mundësitë për ratifikimin e marrëveshjes", tha Haradinaj.

Në një përlogaritje të thjeshtë,

nëse PDK, AAK, Nisma dhe LDK bashkë me pakicat jo serbe në Kuvend e votojnë marrëveshjen, megjithatë nuk sigurohen ende 80 votat e kërkuara. Të gjitha këto subjekte së bashku kanë 78 vota gjithsej. Andaj, ratifikimi i Demarkacionit mbetet ende i varur edhe nga 2-3 vota që duhet të sigurohen nga Lëvizja Vetëvendosje

dhe Lista Serbe. Megjithatë, deri në këtë fazë, Haradinaj ka konfirmuar po ashtu se nuk ka marrëveshje që garanton votat nga Lista Serbe, e cila është pjesë e koalicionit qeverisës. "Ende nuk kemi konsensus me Listën Serbe, nuk e di a do të arrihet", tha Haradinaj. Komisioni Evropian e ka bërë të qartë se pa ratifikimin e demarkacionit,

Kosova nuk do të mund të përfshihet në zonën e lëvizjes së lirë, brenda BE-së, pa viza. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka mirëpritur gatishmërinë e partive të koalicionit për të pranuar propozimin e LDK-së lidhur me projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi. "Kjo e hap rrugën që sa më parë në Kuvendin e Kosovës të ratifikohet kjo marrëveshje dhe të kërkojmë nga BE-ja që qytetarët e Kosovës të lëvizin lirshëm, sikurse qytetarët e vendeve të tjera të rajonit", tha Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së. Hoti tha për Radion Evropë e Lirë se bashkë me ligjin në fjalë dhe para se deputetët ta votojnë këtë marrëveshje, pra në formë informuese do t'i ketë të gjitha raportet e komisioneve. LDK-ja, tha Hoti, fton edhe subjektin politik Lëvizja Vetëvendosjen që të bashkohet në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi është nënshkruar në gusht të vitit 2015 në Vjenë. Si e tillë, kjo marrëveshje ishte ratifikuar nga Kuvendi i Malit të Zi, por jo edhe nga ai i Kosovës. Afati i fundit për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, në mënyrë që Kosova të përfshihet në agjendën për liberalizimin e vizave, mbetet 28 shkurti, kur edhe është caktuar vazhdimi i seancës.

VESELI FALËNDERON LDK, HARADINAJN, PACOLLIN DHE NISMËN

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, njëherësh kryetar i Kuvendit, Kadri Veseli, në një postim në Facebook, ka konfirmuar një pajtim për ta votuar demarkacionin në seancën e së mërkurës. Ai i ka falënderuar partitë e koalicionit, si dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës për bashkëpunimin, që sipas tij, duhet t'i përcjellë edhe në procese tjera. "Sapo kemi arritur konsensusin për të ratifikuar

Marrëveshjen për shënimin e kufirit me Malin e Zi. Dëshiroj të falënderoj kryeministrin Haradinaj, Lidhjen Demokratike të Kosovës, Nismën Socialdemokrate dhe zëvendëskryeministrin Pacolli, për gatishmërinë për konsensus dhe për dialogun shumë konstruktiv. Ky bashkëpunim duhet të na përcjellë edhe në procese të tjera të rëndësishme për vendin", ka shkruar Veseli në Facebook.

VRASJA E IVANOVIQIT, SERBINË NË LISTËN E ZEZË TË VENDEVE QË FINANCOJNË TERRORIZMIN

Tadiq ka thënë se vrasja e Oliver Ivanoviçit, liderit të Iniciativës Qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi" (SDP), "ka lidhje me krim të organizuar, pastrim parash dhe e ndërlidh Serbinë me vendet më të zeza të botës"



ste. "Serbia, qysh dje është përfshirë në 'LISTËN E ZEZË', bashkë me Jemenin, Sirinë, Irakun, me shtetet që marrin pjesë në pastrim parash, institucionet e të cilave nuk e pengojnë këtë gjë dhe institucionet e të cilave nuk pengojnë dërgimin e parave organizatave terroriste. Këtë Qeveria jonë po e fsheh nga opinioni", u ka deklaruar Tadiq gazetarëve para Presidencës serbe, njofton agjencia ser-

be e lajmeve B92. Sipas këtij mediumi, nga kjo listë është hequr Bosnja e Hercegovina, ndërsa është përfshirë Serbia, që e bën vendin e vetëm nga Ballkani i cili ka gjetur vend në këtë listë bashkë me vendet e nxira, është shprehur ai. Tadiq ka thënë se vrasja e Oliver Ivanoviçit, liderit të Iniciativës Qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi" (SDP), "ka lidhje me krim të organizuar, pastrim parash dhe e ndër-

lidh Serbinë me vendet më të zeza të botës".

"E gjithë kjo ndërlidhet në sistemin të përbashkët, e kjo është hallka e shtetit me krimin e organizuar, që prodhon rrezik për jetën jo vetëm të qytetarit siç ishte Oliver Ivanoviç, por për të gjithë qytetarët", ka vlerësuar ish-presidenti i Serbisë, Boris Tadiq.

"Vrasja e Oliver Ivanoviçit është vrasja e katërt politike që ka

ndodhur në 20 vjetët e fundit në Serbi dhe ne jemi i vetmi vend në territorin e Evropës ku ka ndodhur diçka që turpëron të gjithë përfaqësuesit e shtetit", ka shtuar ai. Përveç kësaj, Tadiq ka rikujtuar se Ivanoviç para se të vritej kishte tërhequr vërejtjen për kërcënime dhe se për këtë kishte informuar Agjencinë Informative të Sigurisë (BIA), por Ivanoviçin askush nuk e kishte mbrojtur.

VRASJA E IVANOVIQIT, ME AUTOMATIK E JO PISTOLETË

Politikani serb në Kosovë, Oliver Ivanoviç është vrarë me një armë automatike "Heckler & Koch", e jo siç ishte njoftuar më parë nga një pistoletë "Zastava" e kalibrit 9 mm. Këtë e bën të ditur gazeta serbe "Vecernje Novosti". Duke cituar burime të hetuesisë në Kosovë, ajo pohon se në ditën e vrasjes, më 16 janar, një automjet i llojit "Opel Astra" e ka ndjekur Ivanoviçin që nga momenti kur ai doli nga banesa e tij në Mitrovicë, e deri para

selisë së partisë në rrugën "Sutjeska". Kur Ivanoviç u afrua portës së oborrit ku gjenden zyrat e partisë, një person që gjendej në sediljen e pasme të veturës ka hapur zjarr mbi të. Sipas rezultateve të autopsisë, Ivanoviç u qëllua me 6 plumba në pjesën e sipërme të gjoksit. Vrasësit, sipas "Vecernje Novosti", u arratisën me të njëjtën makinë drejt shkollës mjekësore dhe fshatit Brdani, ku edhe i vunë zjarrin automjetit.

KRYQI I KUQ E PRANON: 21 anëtarë abuzuan seksualisht më fëmijë!

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) ka njoftuar se 21 pjesëtarë të stafit të tij janë larguar nga detyra për veprime të pahijshme seksuale përgjatë 3 viteve të fundit. Drejtori i përgjithshëm i ICRC-së, Yves Daccord tha se individët në fjalë kanë paguar për "shërbime seksuale" dhe kanë dhënë dorëheqjen ose janë shkarkuar nga agjencia e ndihmës. Ai shtoi se ajo ishte "një ditë e vështirë, por e rëndësishme". Zbulimi vjen pasi sektori i ndihmës është tronditur nga një numër i pazakontë akuzash për abuzime seksuale dhe shfrytëzim nga punonjësit e tij. Daccord tha më tej se, kanë qenë pikërisht raportimet më të fundit për ngacmime seksuale nga agjencitë humanitare, që nxitën ICRC-në me seli në Gjenevë të kryenin një hetim të brendshëm. Kodi i sjelljes e ka të ndaluar në mënyrë të qartë "blerjen" e shërbimeve seksuale që prej vitit 2006. Zbulimi i fundit vjen pas raporteve se Plani Ndërkombëtar, një fondacion bamirësie në ndihmë të fëmijëve, konfirmoi 6 raste abuzimi seksual dhe shfrytëzimi të miturish nga stafi ose bashkëpunëtorët e tjerë. "Kam udhëzuar ekipet e mia të rrëmojnë në të dhënat që kemi mbi rastet e ngacmimeve seksuale, e mund t'iu them se që prej vitit 2015, ne kemi identifikuar 21 pjesëtarë të stafit që ose janë shkarkuar për pagesa për shërbime seksuale, ose kanë dhënë dorëheqjen gjatë hetimit të brendshëm", tha Daccord. Dy pjesëtarë të tjerë të stafit, që dyshoheshin për sjellje të pahijshme seksuale, nuk u janë rinovuar kontratat, deklaroi më tej ai, duke shtuar se "ishite thellësisht i zhgënjyer që raportonte këto shifra".

Gjykata belge u lejon mbulesën nxënësve muslimane

Një gjykatë në Belgjikë ka vendosur se ndalesa e mbulesës për vajzat muslimane në shkollat lokale është kundër lirisë fetare. Prindërit e 11 nxënësve morën masa kundër ndalimit të mbulesës në shkollat flamane në rajonin Maasmechelen. Gjykata tha se ajo mori parasysh dispozitat e bëra në Traktatit Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe vendosi që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian (BE) duhet t'i lejojnë qytetarët e tyre të praktikojnë fenë e tyre në liri të plotë. Vendimi i gjykatës nuk mbulon ndalimin e përgjithshëm të shkollave flamande në rajon, por 11 nxënës do të mund të mbajnë mbulesën në shkollat e tyre 30 ditë më vonë. Menaxheri i përgjithshëm i Fondacionit të Dijanetit në Belgjikë, Coşkun Beyazgül, i cili është i lidhur me trupin më të lartë fetar të Turqisë, tha se institucioni që përfaqëson poashtu mori pjesë në këtë rast për të mbështetur nxënës të muslimane. Beyazgül tha se vendimi i gjykatës është një shembull për rastet tjera në vend. Në vitin 2015, Autoriteti belg i Komunitetit Flaman për Arsimit (GO!) ndaloi mbulesën e kokës në shkollat shtetërore flamane.



VRASJA E FËMIJËVE DHE PRAPË BOTA PO E KTHEN KOKËN

Sot, në Gutën Lindore, sikurse në Srebrenicë më 1995, krime të tmerrshme që mund të përbëjnë gjenocid janë duke u kryer. Në nëntor, Mlladiqi përfundimisht u dënua për gjenocid në Hagë. U deshën 22 vjet. Edhe sa fëmijë duhet të vdesin para se të ketë drejtësi në Siri?

Me çdo fëmijë që vdes, me çdo vepër brutaliteti që kalon pa u ndëshkuar, Guta Lindore vazhdimisht e më shumë po i ngjan asaj që Kofi Annan dikur e quajti krimin më të rëndë të kryer në tokën evropiane që nga 1945. Guta Lindore po kthehet në Srebrenicë e Sirisë. Sikurse enklava e myslimanëve të Bosnjës më 1995, Guta Lindore, në dalje të Damaskut, është rrethuar nga forcat e regjimit që në fazat e para të luftës së Sirisë. Përpjekjet disa vjeçare kanë dështuar për të larguar fraksionet rebele që e kontrollojnë atë, raporton "The Guardian". Siç ndodhi edhe në Srebrenicë, furnizimi me ushqim, asistencë humanitare dhe mjekësore është ndërprerë. Më 1993, OKB e cilësoi Srebrenicën si "zonë të sigurt". Vitin e kaluar, si pjesë e procesit të dështuar paqësor të Moskës në Astana, rusët e shpallën Gutën Lindore "zonë de-eskalimi".

Pa dobi. Sikurse në Bosnje, askush nuk provoi të mbronte popullatën civile kur nisi ofensiva e regjimit atje në dhjetor pas dështimit të negociatave. Sulmet ajrore dhe bombardimet që tani po marrin shumë jetë po ndërmerrin pa asnjë ndëshkim nga forcat siriane dhe përkrahësit e tyre rusë. OKB-ja pothuajse iu përgjyera koalicionit pro-Assad, ku përfshihet milicia e udhëhequr nga Irani, që të pajtohen për një armëpushim të menjëhershëm humanitar. Apelet janë injoruar. Edhe lutjet e agjencive humanitare kanë shkuar në veshë të shurdhër. Vëmendja e fuqive të mëdha - SHBA dhe Rusia - dhe aktorëve rajonalë si Turqia, është e përqen-

druar në një lojë të madhe strategjike të luajtur mbi kufomat e gjysmë milioni sirianëve. Sytë e tyre janë kah kontrolli në të ardhmen i një vendi të ndarë efektivisht në zona të ndikimit. Për administratën Trump, kjo do të thotë frenim i ambicieve të Iranit për të krijuar një "urë tokësore" për në Mesdhe, apo një "gjysmëhënë shiia" që do të shtrihej nga Herati në Afganistan deri në luginën Bekaa në Liban. Për turqit, e tëra ka të bëjë me shkatërrimin e kurdëve. Për Vladimir Putinin, ka të bëjë me pushtetin. Por për banorët e Gutës Lindore, e tëra ka të bëjë me mbijetesën. Një numër rekord i njerëzve kanë vdekur në 36 orët e fundit në një zonë kur numri total i vdekjeve që nga viti 2011, kur nisi lufta, llogaritet në disa mijëra. Dhe nuk ka shpëtim.

Më shumë se 100 të vdekur, mbi 500 të plagosur dhe pesë spitale të bombarduara. Dhuna është e pamëshirshme dhe padurueshëm mizore. Në Srebrenicë, rreth 8,000 burra dhe fëmijë myslimanë u masakruan në pak ditë. Mes 25,000 dhe 30,000 gra, fëmijë e të moshuar boshnjakë iu nënshtruan zhvendosjes së detyrueshme dhe abuzimit. Tribunali ndërkombëtar për krime lufte për ish-Jugosllavinë më vonë dekretoi se këto krime përbënin gjenocid, transmeton Koha.net.

Në atë kohë, bota qëndroi prapa dhe shihte tekta ushtria e serbëve të Bosnjës e Gjeneralit Ratko Mlladiqi dhe paramilitarët 'Scorpion' rrethonin zonën, duke tejkaluar paqeruajtësit holandezë. Komuniteti

ndërkombëtar e dinte shumë mirë se çfarë mund të bënte Mlladiqi, se masakra ishte e pashmangshme. Shikoi në anën tjetër. Agonia e Gutës Lindore, tashmë e njohur për të keq për sulmin kimik të vitit 2013 me gaz sarin, është më e ngadaltë por e injoruar ngjashëm. Edhe njëherë civilët, përfshirë numër të madh fëmijësh, po vriten. Edhe njëherë, fuqitë perëndimore, me forcat e tyre të vendosura në vend, refuzojnë të intervenojnë. Edhe njëherë, OKB-ja është e pafuqishme, këshilli i sigurimit i pafuqishëm si pasojë e vetove ruse. "Ky mund të jetë një prej sulmeve më të ashpra në historinë siriane, madje më i ashpra se rrethimi i Aleppo... Shënjestrimi dhe vrasja sistematike e civilëve përbën krim lufte dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të veprojë për të ndaluar atë", ka thënë Zaidoun al-Zoabi nga Unioni i pavarur i Organizatave të Kujdesit Mjekësor dhe Ndihmës Humanitare.

Por, së paku për tani, presidenti i Sirisë, Bashar al-Assad - sikurse Mlladiqi më 1995 - duket të jetë i papërshtueshëm nga arsyeja apo presioni i jashtëm. Dëshmitë që implikojnë Assadin në krime lufte dhe në krime kundër njerëzimit janë të shumta. Deri më tani asnjë aktakuzë nuk është ngritur, dhe ai vazhdon i pashqetësuar. Sot, në Gutën Lindore, sikurse në Srebrenicë më 1995, krime të tmerrshme që mund të përbëjnë gjenocid janë duke u kryer. Në nëntor, Mlladiqi përfundimisht u dënua për gjenocid në Hagë. U deshën 22 vjet. Edhe sa fëmijë duhet të vdesin para se të ketë drejtësi në Siri?

MIRATOHET REZOLUTA PËR ARMËPUSHIM 30 DITOR NË SIRI

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka miratuar në mënyrë anonime një rezolutë, me anë të së cilës kërkohet armëpushim 30-ditor në Siri, transmeton BBC. Të 15 anëtarët e këshillit, kanë votuar për të lejuar dërgimin e ndihmave humanitare, pas luftimeve intensive në Ghoutën Lindore. Sulmet në këtë zonë që gjendet afër Damaskut, kanë nisur nga forcat qeveritare, të cilat kanë thënë se kanë cak rebelët që kontrollojnë enklavën. Marrëveshja për armëpushim ka ditë që synohet të arrihet, mirëpo është përballur me mospajtime. Rusia, aleate e qeverisë siriane ka kërkuar ndryshime. Ambasadorja amerikane në OKB, Nikki Haley, ka bërë thirrje që armëpushimi të fillojë të zbatohet menjëherë, mirëpo ajo ka thënë se ka dyshime nëse Siria do t'i përmbahet. Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e Njeriut me bazë në Britani, ka thënë se 500 persona janë vrarë në Ghoutën Lindore, prej ditës së diel. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, ka thënë se situata në këtë enklavë është "ferri në Tokë".

PËRTEJ DASHURISË SË MBRETËRESHËS VIKTORIA DHE PRINCIT ALBERT



Martesa mes dy kushërinjve të parë, mbretëreshës së re Viktoria dhe princit gjerman simpatik dhe të mençur - Albert, ishte një përplasje dashurie. Përgjatë 17 viteve, lindën nëntë fëmijë: katër djem dhe pesë vajza. Piktura dhe fotografi paraqitën imazhin e një çifti të përkushtuar të rrethuar nga fëmijë të bindur e të ëmbël. Megjithëse seksualisht të magjepsur, çifti i ri ishte bllokuar në fakt në një luftë për pushtet.

Alberti mori gjithnjë e më shumë detyra nga mbretëresha, ndërsa shtatzënitë e saj e detyronin të qëndronte menjëherë. Dhe Viktoria nuk ishte e kënaqur për këtë: ajo e admironte "engjellin" e saj për talentet dhe aftësitë e tij, por ishte veçanërisht e shqetësuar për shkakun se po i grabitej pushteti si mbretëreshë. Ka pasur edhe grindje të tmerrshme, ndërsa Alberti ishte llahtaritur nga temperamentit i shpërthimeve të Viktorias. Gjithmonë thellë në mendjen e tij ekzistonte frika se ajo mund të kishte trashëguar çmendurinë e mbretit Xhorxh III. Ndërsa ajo ecte furishëm nëpër pallat, ai fshihej duke mbajtur shënime.

Megjithëse ajo ishte nënë shumë herë, Viktoria urrente të mbetej shtatzënë. Shtatzënitë e përsëritura ajo i konsideronte "më shumë si lepujt apo derrat e Guinesë sesa çdo gjë tjetër jo shumë e këndshme". Ajo nuk pëlqente veçanërisht ushqimin me gji dhe e konsideronte atë një praktikë neveritëse. Ajo nuk ishte as shumë e daluar si nënë, megjithëse ishte mjaft e kujdesshme në zbatimin e detyrës së saj për të qenë "e ashpër". Ajo nuk ofronte afeksin. Marrëdhëniet me djalin e saj më të madh, Berti, i cili më vonë u bë Eduardi VII, qenë veçanërisht të dobëta. Që në fillim ai ishte një zhgënjim për mbretëreshën. Si të gjithë princërit mbretërorë, ai u arsimua në shtëpi me një mësues. Berti eci shumë keq në mësimet dhe prindërit e tij e menduan si gjysmak. Viktoria shkroi: "Nuk mendoj se është i pashëm me atë kokë të vogël

dhe të ngushtë deri në dhimbje, me ato tipare të stërmëdha dhe nevojës për mjekër". Kur Berti ishte 19 vjeç, ai kaloi disa kohë duke u stërvitur me ushtrinë në Irlandë dhe një prostitutë me emrin Nellie Klifden u fut fshehtas në krevatin e tij. Kur kjo ngjarje mbërriti tek Alberti, ai e priti shumë keq.

Shpejt pas kësaj, Alberti vdiq. Cilido qoftë shkak i vdekjes, për shumë vite më vonë, Viktoria ia vuri fajin Bertit për vdekjen e tij dhe shmangu të kalonte kohë me të. Për 40 vitet që vijuan, Viktoria qëndroi e veshur me të zeza dhe u shfaq në publik rrallë dhe pa dëshirë. Për popullin e saj, ajo ishte e imta "Vejushë e Uindsorit", një figurë patetike e goditur nga trishtimi. E vërteta ishte shumë e ndryshme. Megjithëse Viktoria ishte e padukshme, nevoja e saj për të kontrolluar fëmijët e vet ishte pothuajse patetike. Ajo krijoi një rrjet spiunësh dhe informatorësh, të cilët raportuan mbi çfarë po bënin fëmijët e saj. Kur Berti u martua me një princeshë daneze, Viktoria urdhëroi mjekun e saj të raportonte çdo detaj mbi shëndetin e nuses, përfshirë edhe ciklin e saj menstrual. Ballot e oborrit u organizuan në mënyrë të tillë që të mos përkonin me periodat e princeshës. Vajza e madhe e mbretëreshës Viki u martua me Fritz, trashëgimtari i fronit të Prusisë, kur ishte 17 vjeç.

Ajo u bë nëna e Kaizerit Uilliam II. Megjithëse larg në Gjermani, Viki nuk u shpëtoi dot ndërhyrjeve nga e ëma. Kur Viki njoftoi se ajo ishte shtatzënë, Viktoria iu përgjigj: "Ç'lajm i tmerrshëm... na ka mërzhitur deri në vdekje". Viki dhe motra më e vogël, Alise, e cila u martua gjithashtu me një princ gjerman, bënë komplot ndaj mendimeve të nënës së tyre. Në mënyrë sekrete, ato i ushqyen fëmijët e tyre me gj. Kur Viktoria e mësoi këtë gjë, u zemërua shumë dhe i quajti "lopë". Ndryshimi i qëndrimeve të Viktorias qenë habitëse, ndërsa shpërthimet e saj në zemërim mund të bëheshin tmerruese. Ajo e

Ka pasur edhe grindje të tmerrshme, ndërsa Alberti ishte llahtaritur nga temperamentit i shpërthimeve të Viktorias. Gjithmonë thellë në mendjen e tij ekzistonte frika se ajo mund të kishte trashëguar çmendurinë e mbretit Xhorxh III. Ndërsa ajo ecte furishëm nëpër pallat, ai fshihej duke mbajtur shënime

bëri gjithmonë të qartë për fëmijët e vet se nuk ishte vetëm nëna e tyre, por edhe sovranja, dhe ata nuk duhet ta harronin kurrë këtë. Ajo mbajti vajzën më të vogël, Beatrice në shtëpi. Vajza u tmerrua nga e ëma. Viktoria dëshironte që Beatrice të mbetej e pamartuar. Kur vajza njoftoi se ishte fejuar me një princ gjerman joshës, Viktoria refuzoi t'i flasë për gjashtë muaj dhe pranoi martesën vetëm me kushtin që çifti të jetonte bashkë me të.

Rebelja e kishte emrin Luiza. Flirtuese, tërheqëse dhe shumë reaguese, ajo refuzoi të martohej me një princ gjerman. Në vend të tij, ajo zgjodhi lordin Lorne. Ky rezultoi gabim. Martesa nuk solli fëmijë, ndërsa Lorne i mërzhitur jetoi me thashethemin se ishte gej. Viktoria i kontrolloi djemtë e saj po kaq ngushtë. Leopold, i cili trashëgoi hemofilinë, vuajti veçanërisht shumë. Viktoria e përshkroi atë si një "fëmijë me pamje tepër të zakonshme". Ajo u përpoq ta detyronte atë të jetonte si një invalid, duke e lidhur me fasho pambuku. Si fëmijë, ai u tall nga shërbëtorët e vet që ishte ngarkuar të përkujdesej për të, por Viktoria refuzoi të dëgjojë ankesat e tij. Ai vdiq në moshën 32-vjeçare. Por djali me të cilin u grind më shumë, ishte djali i madh Berti. Në një rast, Viktoria tha se problemi me të, ishte se Berti qe tepër i ngjashëm me të. Ajo kishte të drejtë. Njësoj si e ëma, Berti ishte i babëzitur dhe tepër seksi me temperament shpërthyes. Por ai gëzonte edhe një dhuratë të madhe, kishte sharm personal. Si princ i Uellsit, Berti kaloi nga një skandal në tjetrin. Viktoria nuk e lejoi atë të shikonte dokumentet e qeverisjes pavarësisht kërkesave të tij të përsëritura. Por historia pati një fund të papritur. Berti nuk i prishi kurrë marrëdhëniet me nënën e tij. Kur në fund ai e zëvendësoi të ëmën si monarkë në moshën 58-vjeçare, ai qeverisi mirë. Berti e modernizoi monarkinë, dhe puna e tij ishte një nga arsyet që shpjegojnë se monarkia britanike i mbijetoi Luftës së Parë Botërore.

Ana, gruaja që shpëtoi Dostojevkin nga kumari



Në verën e vitit 1865, kur sapo kishte nisur të shkruante "Krim dhe ndëshkim", një nga romanierët më të mëdhenj të të gjitha kohërave nuk ishte në gjendjen e tij më të mirë. I mbetur i ve, Dostojevski humbi edhe të vëllain. I mbytur në borxhe për shkak të vesit të kumarit, Dostojevski trashëgon edhe borxhet e të vëllait dhe shumë shpejt kreditorët nisën t'i trokasin në derë, duke e kërcënuar me burg. (Një dekadë më herët, ai mrekullisht i kishte shpëtuar dënimit me vdekje për shkak të leximit të librave të ndaluar).

I dëshpëruar, shkrimtari pranoi të shiste të drejtat e një koleksioni historik dhe pjesë e marrëveshjes ishte edhe një roman i ri me të paktën 175 faqe që duhej të ishte gati në nëntorin e një viti më pas. Duke mos pasur rrugëzgjdhje, Dostojevski vendosi të përmbushte kontratën, por ishte kaq i përfshirë nga "Krim dhe ndëshkim" sa e kaloi gjithë vitin duke punuar mbi të në vend që të shkruante romanin "Kumarxhiu", që ishte pjesë e kontratës. Me ardhjen e tetorit, Dostojevski duhej të shkruante gjithë romanin në 4 javë. Më 15 tetor ai i kërkoi një miku që t'i sugjeronte një stenograf të mirë. Pa hezitim, miku profesor i sugjeroi emrin e një gruaje të re, Ana Grigoryevna Snitkina. 20-vjeçarja u entuziazmu nga oferta; Dostojevski ishte shkrimtari i preferuar i babait të saj dhe ajo ishte rritur me librat e tij. Të nesërmen ata filluan punën: ai diktonte, ajo shtypte në makinë.

Gjatë 25 ditëve në vijim, Ana shkante çdo ditë në shtëpinë e shkrimtarit. Çdo ditë ai bëhej më i qetë dhe më i sjellshëm me vajzën. Me ndihmën e Anës, Dostojevski arriti ta përfundonte librin në kohë. Në përfundim të punës, ai e pagoi dhe e falënderoi. Ditën tjetër, me rastin e 45-vjetorit të tij, Dostojevski vendosi të organizonte një drekë, ku ftoi edhe Anën. Në atë drekë ai kuptoi se Ana ishte bërë drita e ditëve të tij dhe se puna me të i jepte kënaqësi. Duke mos e imagjinuar më jetën pa të, ai i kërkoi ta ndihmonte që të përfundonte "Krim dhe ndëshkim". Më 20 nëntor, 10 ditë pas përfundimit të projektit të parë, ai e ftoi Anën në shtëpinë e tij. Të dy u futën në studion e tij, ku ai i propozoi martesën në mënyrën më të mrekullueshme. Dostojevski i tha Anës se do të donte të dinte mendimin e saj mbi një roman që po shkruante. Por sapo nisi t'i tregonte historinë u bë e qartë se për çfarë bëhej fjalë, ishte historia e atyre të dyve. Ata u martuan më 15 shkurt 1867. Edhe pse patën vështirësi financiare dhe përjetuan tragjedi familjare, përfshirë humbjen e dy fëmijëve të tyre, ata e deshën njëri-tjetrin dhe qëndruan bashkë deri në vdekjen e shkrimtarit. Pas vdekjes së tij, Ana studioi tregun e botimeve dhe punoi fort duke e bërë të shoqin një markë kombëtare, librat e cilit u shitën në miliona kopje. Sot shumë e konsiderojnë atë si gruan e parë që drejtonte një biznes në Rusi.

NUDOT E SHËMTUARA TË LUCIAN FREUD



Lëkurë e ekspozuar, e pambrojtur, shkëlqimtare, tul pasiv, i bardhë në rozë, mjegulluar me gri e blu, shtrihej gjithkund. Piktori më i mirë në botë, siç thuhej shpesh se ishte, dukej se e kishte për zemër që t'ia përplaste botës në fytyrë shëmtinë njerëzore

Trupi i tyre nuk është i bukur. Ato janë të shëndosha dhe pozojnë nudo duke treguar pa ndroje trupin e tyre. Tronditje, ndoshta edhe përçmim, ishte, shpesh, reagimi ndaj pikturave të Lucian Freud-it kur ato ekspozoheshin për herë të parë. Te "Benefits Supervisor Sleeping" një grua e stërmadhe shtriqet përgjumshëm në kanape, me një gji të dhjamtë në kupë të një dorë, këndellur në rrrathë tulli të trashë, si një balenë në cektinë. Te "Naked Man with Rat" një burrë syshqyer nga habia përkëdhel një mi fare afër gjenitaleve të veta. Femrat nudo-nganjëherë vajzat e rritura të artistit-hapen pa të keq, ose mbështillen në çarçafë. Lëkurë e ekspozuar, e pambrojtur, shkëlqimtare, tul pasiv, i bardhë në rozë, mjegulluar me gri e blu, shtrihej gjithkund. Piktori më i mirë në botë,

siç thuhej shpesh se ishte, dukej se e kishte për zemër që t'ia përplaste botës në fytyrë shëmtinë njerëzore. Ai ishte i drejtpërdrejtë në mënyrë tronditëse. Ajo që spektatorët shpesh nuk kuptonin, ishte se Freud-i donte të trondiste vetveten. Çdo portret bartte rrezik. Sa herë që i afrohej një modeli-me një copë të shqyer futur në rrip si përparësia duke bërë pak vend në mbishtresat e paletës së tij, duke shkundur bojën e tharë nga tubetat-ai ndihej, siç thoshte vetë, si një zhytës para se të hidhej.

As e kishte idenë se ç'do të ndodhte. Teksa ngarkonte furçën me bojë dhe i afrohej pëlhurës, nervoz dhe pa peshë, ai po hidhte zaret e një rreziku të jashtëzakonshëm, bash siç, kur në rini, mbyllte sytë dhe futej në trafik vetëm sa për të parë nëse dilte dot në anë tjetër, apo


kur ishte i varfër dhe i hidhte të gjitha paratë në baste duke humbur me ndërgjegje edhe qindarkën e fundit, për t'u kthyer më pas në shtëpi i mbushur me gëzim, pa asnjë pare në xhep. Çdo portret ishte pa lidhje me paraardhësin, një habi edhe për vetë atë. Çdo pikturë duhej bërë më mirë. Jo domosdoshmërisht 'i ngjashëm' me subjektin, por disi të ishte ai person, i gjallë në pikturë. Modelimi për të merrte muaj e vite, ndërprerë nga biseda të mençura dhe darka në Wolseley, kohë gjatë së cilës ai nuk pushonte së vëzhguari, së përkthyeri çdo grimasë dhe lëvizje në një të rënë të vetme të furçës, derikur në shtresa të dhimbshme pune shfaqej personi. Metoda e tij ishte pasqyrim i vizatuesit të brendshëm tek ai.

Djaloshi që erdhi në Angli nga

Berlini në moshën 10-vjeçare, skicoonte gjatë gjithë kohës; artisti i ri, duke iu kundërvënë përçmimit të viteve '40 për artin figurativ, bënte vizatime që ishin lineare, të sheshta e pafundësisht të detajuara, vijëzime të hijezuara nëpër portrete, me ngulmim skrupuloz, të llojit të Dürer-it, deri te gëzofi i majmunëve të vdekur dhe flokët e ngatërruar të të dashurave të tij. E gjitha ndryshoi papritur në vitin 1959 me "Woman Smiling". Nga pozicioni ulur ai u ngrit në këmbë; këmbu furçat e holla me ato me qime derri dhe pëlhurat e lëmuara për të ashprat; i dha fund vizatimeve dhe kaloi direkt në bojë, duke përmbysur çdo gjë që më parë dukej si Lucian Freud. Ai refuzoi të ishte i parashikueshëm, ashtu siç refuzoi të ishte i ndikueshëm nga çdo artist tjetër. (Gazeta Shqip)

Kur Winston Churchill shpëtoi botën mbarë

"Darkest Hour" zhvillohet pothuaj ekskluzivisht në mjedise të mbyllura në seancat e Parlamentit, takime private dhe skena mes Churchillit dhe bashkëshortes së tij brilante, Clementine. Por dialogu është imponues, aktrimi i shkëlqyer



Filmi i ri "Darkest hour" ofron anën diplomatike të një tjetër filmi aksion të kohëve të fundit, "Dunkirk". Kështu shkruan historiani amerikan, Victor Davis Hanson, në lidhje me filmin më të fundit që i kushohet Kryeministrit britanik, Winston Churchill, gjatë pushtimit të Francës prej nazistëve, në maj 1940. Filmi ndjek Churchillin, rol që e luan Gary Oldman, në fillimet e Luftës së Dytë Botërore.

"Paraardhësi i Churchillit, shëndetligu Neville Chamberlain kishte humbur besimin e popullit anglez

dhe qeverisë britanike. Qasja e tij e zbutjes kundrejt Adolf Hitlerit dhe nëntë muajt e parë katastrofikë të Luftës së Dytë Botërore, dukej se pothuaj e kishin dënuar Britaninë e Madhe me disfatë. Churchillit iu kërkua të bëhet Kryeministër, pikërisht në ditën kur Hitleri pushtoi Francën, Belgjikën dhe Holandën. Ushtritë e të tre demokracive - të treja së bashku, më të mëdha se forcat e armatosura të Gjermanisë - u gjuhëzuan brenda pak ditësh apo javësh. Problemi madhor i Churchillit nuk ishte të shpëtonte

vetëm ushtrinë britanike, por të përballej me realitetin që, me pushtimin gjerman të Evropës, perandoria britanike nuk do të kishte më aleatë. SHBA ishin të vendosura me çdo kusht që të mbeteshin neutralë. Brenda pak ditësh pasi Churchill mori detyrën, gjithë ai që sot është Bashkimi Evropian, do të kish qenë në duart e Hitlerit. Ora më e errët e merr titullin nga depresioni që ishte përhapur në të gjithë qeverinë britanike. Chamberlain dhe politikani konservator, Edward Wood e konsideronin

Churchillin të çmendur, për faktin që kish besuar se Britania e Madhe mund të mbijetonte. "Darkest Hour" zhvillohet pothuaj ekskluzivisht në mjedise të mbyllura në seancat e Parlamentit, takime private dhe skena mes Churchillit dhe bashkëshortes së tij brilante, Clementine. Por dialogu është imponues, aktrimi i shkëlqyer. Interpretimi madhështor që Gary Oldman i ka bërë Churchillit duhet të jetë fitues Oscar-i. Oldman u kujton brezit të të rinjve që i ka zënë një amnezi globale se pothuaj 80 vjet më

parë, sfida kokëfortë e një anglezi viktorian 66-vjeçar shpëtoi qytetërimin perëndimor nga barbaria naziste. Amerikanët duhet ta shohin "Darkest Hour" për arsye që shkojnë përtej interpretimit dhe dramës. Me të drejtë mendojmë se industria amerikane dhe krahu i punës sovjetik fituan Luftën e Dytë Botërore. E megjithatë shumë shpesh, amerikanët harrojnë ingredientin e tretë themelor: udhëheqësin britanik, kurajon e tij dhe profesionalitetin ushtarak". (bota.al)

Kafe, shumë përfitime në një filxhan



Ekspertët tashmë bien dakord: Kafja, e konsumuar në sasi të arsyeshme, 2-4 filxhanë në ditë, ka mjaft përfitime

Kafja jo vetëm që është një kënaqësi me aromën e saj intensive, por ka një sërë përfitimesh. Një nga arsytet që nuk bëjmë dot pa të është se kafja, e konsumuar në sasi të duhura, është një aleat i mirë i shëndetit dhe mirëqenies. Vetëm një filxhan është një nga kënaqësitë e vogla, të mëdha të jetës, aq sa shumë prej nesh nuk e nisin dot ditën pa e pirë një gllënjë kafe, ashtu si dhe gjatë ditës një pushim i shkurtër kafeje na duhet për të qenë të përqendruar. Por nga ana tjetër ekspertët tashmë bien dakord: Kafja, e konsumuar në sasi të arsyeshme, 2-4 filxhanë në ditë, ka mjaft përfitime.

- Vjen e para. Dihet se konsumimi i kafes përmirëson performancën e atleteve duke rritur rezistencën e tendosjes fizike. Kjo pasi një kafe e mirë para praktikimit të sportit, rrit nivelin e acideve yndyrore në gjak, që konsumohen më pas për të prodhuar energjinë e nevojshme për të mbështetur tendosjen fizike.

- Jo vetëm sport. Kafja përmban substanca antioksiduese natyrale, molekula që ngadalësojnë dhe neutralizojnë dëmet e shkaktuara nga radikalet e lira dhe ndihmon në parandalimin e plakjes.

Për më tepër është parë se ka një veprim mbrojtës ndaj shëndetit të mëlçisë, dhe efekte të rëndësishme antidepresive thonë shkencëtarët e universitetit të Harvardit.

- Lamtumirë dhjamë! Kafja është aleat për ata që duan një dietë dobësimi, pasi kafeina redukton sensin e urisë. Por nëse vuajmë nga tensioni i lartë apo probleme me zemrën, e mira është reduktimi i konsumit të saj.



FËMIJËT QË KALOJNË MË SHUMË KOHË ME BABALLARËT JANË MË INTELIGJENTË

Fëmijët bëhen më të mençur kur që fëmijë kalojnë më shumë kohë me baballarët e tyre. Kjo është ajo që del nga një studim i kryer nga një ekip hulumtuesish britanikë nga tre universitete prestigjioze: Imperial College London, King's College London dhe Oxford University. Studiimi i publikuar në "Gazetën e Shëndetit Mendor të Foshnjës" tregon efektet e dobishme që kanë tek fëmijët baballarët. Siç shpjegon "The Telegraph", studiuesit shqyrtuan 128 baballarë të Mbretërisë së Bashkuar, në zona të ndryshme gjeografike dhe klasa sociale, dhe i morën ato me një aparat fotografik, ndërsa shpenzonin kohë me fëmijët e tyre. Në mënyrë të veçantë, ekspertët vërejtën sjelljen e disa baballarëve që ndërvepronin, pa lodra, me fëmijët pothuajse që tre muaj dhe pastaj pothuajse dy vjet ndërkohë që u lexonin libra të vegjëlvë të tyre të rritur. Studiuesit pastaj u kanë bërë fëmijëve një sërë testesh njohëse, duke përfshirë një test për të kuptuar një libër dhe një njohje të formave dhe ngjyrave. Rezultati i parë i qartë tregon se fëmijët që kanë marrë performancat më të mira, qoftë vajzë apo djalë, janë ata që kanë kaluar më

"Ne gjithashtu gjetëm se fëmijët që ndërveprojnë gjatë seancës së leximit me një baba të ndjeshëm, të qetë dhe pak të ankthshëm janë ata të cilët në moshën dy-vjeçare demonstrojnë një zhvillim më të madh dhe aftësi më të madhe gjuhësore dhe aftësi për të zgjidhur problemet", shpjegon Dr. Vaheshta Sethna, nga Kolegji i Mbretit

shumë kohë me baballarët e tyre që në muajt e parë të jetës. "Edhe në fillim të tre muajve të jetës, ndërveprimet midis babait dhe djalit mund të japin rezultate pozitive që mund të vërehen dy vjet më vonë", shpjegon profesor Paul Ramchandani, kreu i hulumtimit, tek BBC. Por nuk mjafton vetëm që baballarët të kalojnë kohë me fëmijët e tyre, ajo që ka rëndësi është mbi të gjitha sjellja dhe gjendja shpirtërore e baballarëve. Në fakt, fëmijët që kanë pasur një prind të depresionuar dhe të introvertuar gjatë muajve të parë të jetës janë ata që kanë marrë rezultatin më të ulët në test. "Ne gjithashtu gjetëm se fëmijët që ndërveprojnë gjatë seancës së leximit me një baba të ndjeshëm, të qetë dhe pak të ankthshëm janë ata të cilët në moshën dy-vjeçare demonstrojnë një zhvillim më të madh dhe aftësi më të madhe gjuhësore dhe aftësi për të zgjidhur problemet", shpjegon Dr. Vaheshta Sethna, nga Kolegji i Mbretit. "Ajo sugjeron që aktivitetet e leximit të ndihmojnë fëmijët dhe për më tepër rezultatet tona tregojnë rëndësinë e të pasurit pranë të një babai pozitiv me fëmijët e tyre", përfundon studiuesja.



Rrezet e telefonave shkaktojnë kancer

Rrezatimi i telefonit celular mund të paraqesë rrezik për kancer të caktuar për disa për disa individë. Kështu thotë një ide e re nga zbulimet paraprake të dy studimeve të reja të mëdha nga Instituti Kombëtar Shëndetësor në Britani. Gjashtë për qind e minjve meshkuj të ekspozuar ndaj të njëjtit lloj rrezatimi eme-

tojnë telefonat tanë celularë - megjithëse në sasi shumë më të mëdha - zhvilluan një lloj kanceri të quajtur "schwannoma" në zemrat e tyre. Ky lloj i studimit është më i madh se Programi Kombëtar i Toksikologjisë që ka kryer ndonjëherë për efektet kancerogjene të rrezatimit të celularit.

Google zhvillon program për parashikimin e rreziqeve kardiovaskulare

Ekspertët e inteligjencës artificiale të gjigantit teknologjik Google kanë zhvilluar një program i cili parashikon rrezikun e sulmit në zemër duke skanuar retinën e syrit. Sipas një lajmi të Business Insider, algoritmi i inteligjencës artificiale, e zhvilluar nga Verily Life Sciences që kryen kërkime shkencore dhe Google, nëpërmjet fotografisë së retinës ka parashikuar drejtë mundësinë e një çr-

regullimi të madh kardiovaskular, siç është sulmi në zemër dhe sulmi në tru brenda pesë viteve tek individët. Kërkimet, rezultatet e të cilave janë publikuar në revistën "Nature Biomedical Engineering", tregojnë se algoritmi me skanimin e syrit fillimisht parashikon moshën e personit, nëse është apo jo i varur nga duhani dhe jep vlerësimet në lidhje me presionin e gjakut. Algoritmi, i cili është tre-

guar i suksesshëm në vlerësimin e këtyre faktorëve, pasi ka shqyrtuar fotografirinë e retinës dhe të dhënat shëndetësore të 284.335 pacientëve, duke bërë përcaktimin e rreziqeve kardiovaskulare. Ekspertët kanë vërejtur se algoritmi nëpërmjet pamjeve të retinës ka parashikuar në 70 për qind të rasteve se cilët individë mund të përjetojnë një çrregullim të madh kardiovaskular.



Samsung Galaxy S9 del në shitje më 16 mars

Samsung Galaxy S9 dhe Galaxy S9+ do të prezantohet të dielën dhe mund të dalë në shitje më pak se një muaj më pas. Sipas "The Investor", kompania koreane do të pranojë porosi për telefonin e ri që

nga 28 shkurti. Shitjet botërore do të nisnin më 16 mars. Çmimi raportohet se do të jetë rreth 900 euro.

Po ashtu, raportohet se kompania planifikon të sjellë versionin me 256 GB

për telefonin Galaxy S9+. Telefoni më i vogël do të vijë vetëm në versionin 64GB hapësirë të brendshme. Sa i përket RAM-it, S9 do të ketë 4GB RAM, ndërsa S9+ do të ketë 6GB RAM.



TË ÇMILITARIZOHET INTELIGJENCA ARTIFICIALE




Inteligjenca artificiale do të jetë përcaktuese për të ardhmen e njerëzimit dhe për këtë, kreu ekzekutiv i Google, Sundar Pichai shprehet i bindur. "Ndërtimi i një inteligjence artificiale plotësisht të pavarur do të jetë zbulimi më i madh në historinë e njerëzimit dhe nuk e teproj po të them se do të jetë edhe më i madh se sh-

pikja e elektricitetit apo zbulimi i zjarrit", deklaroi ai në një seminar me studentë. Por, Elon Musk dhe Stephen Hawking kanë paralajmëruar mbi rreziqet që ka kjo inteligjencë. Që të dy ata kanë kërkuar kujdes në avancimin e saj, pasi mund të rezultojë fatale për fatet e njerëzimit. Sundar Pichai ndan të njëjtin men-

dim. "Sigurisht, rreziku ekziston. Ne duhet të jemi gjithmonë të vëmendshëm dhe të jemi një hap para e t'i kemi nën kontroll. Një hap i rëndësishëm është çmilitarizimi i inteligjencës artificiale. Për këtë, të gjitha vendet duhet të bien dakord që të mos e përdorin këtë formë inteligjence për qëllime ushtarake.

Kjo do të ishte shkatërruese", deklaroi ai. Google është një ndër kompanitë lider në avancimin e inteligjencës artificiale. Deri më tani, gjiganti amerikan i teknologjisë ka njoftuar për disa përparime, por thotë se për të patur një inteligjencë artificiale krejtësisht të pavarur do të duhen ende vite.


Peticionin për të larguar përditësimin e ri të Snapchat



Mbi 1.2 milionë përdorues të Snapchat janë shpërfillur pasi kjo kompani zyrtarisht ka lansuar përditësimin e ri të këtij aplikacioni që nga fillimi i muajit shkurt. Në një përgjigje zyrtare në Change.org, ku përdoruesi Nic Rumseu ka bërë këtë peticion të quajtur "Heqja e përditësimit të ri të Snapchat", ku ekipi i snapchat ka shkruar se ata: "E kuptojnë shumë mirë se Snapchat i ri ka bërë që shumë njerëz të ndihen të parehatshëm". Në këtë deklaratë thuhet edhe se aplikacioni do të 'adaptohet' për secilin përdorues e do të bëhet 'më i mençur me kalimin e kohës'. Aty është prezantuar edhe përditësimi i ri që pritet të dalë për këtë aplikacion, ku do të shtohen edhe butonat si 'Shokët' e 'Gjeni' për ta bërë atë më të lehtë për përdoruesit që ti gjejnë ata që dëshirojnë. Përditësimi i ri i Snapchat ka ridizajnuar mënyrën se si storiët e shoqërisë ndahen në mes të njerëzve që njihim nga yjet e showbizit e markat.

Hipersoniku kinez, për 2 orë nga Pekini në Nju Jork

Inxhinierët kinezë publikuan projektin për ndërtimin e një superavioni hiperskonik, në gjendje që të përshkojë distancën nga Pekini në Nju Jork për dy orë. Aktualisht, me avionët më të shpejtë që ndodhen në qarkullim, udhëtimi nga Pekini në Nju Jork zgjat 14 orë. Shpejtësia me të cilin do të udhëtonte ky mjet në ajër do të shkonte deri në 6 mijë kilometra për orë, ose pesë herë më shpejt sesa shpejtësia e zërrit. Projekti fillestar flet për një avion transporti pasagjerësh e mallrash, por nuk përjashtohet që ushtria kineze të përfshihet në të dhe të kërkojë pajisjen me mjete të tilla në të ardhmen. Avioni është projektuar nga Akademia Kineze e Shkencave në Pekin dhe përmasat e tij mundësojnë transportin edhe të raketave e mbushjeve bërthamore. Mbi një projekt të ngjashëm është duke punuar edhe kompania amerikane Lockheed Martin, por nuk bën të ditur detaje.



Si të kuptoni kur dikush ju ka bllokuar në Facebook

Kur dikush zgjedh të largohet nga jeta juaj nuk është asnjëherë një gjë e mirë, edhe nëse ndodh thjesht virtualisht. Kjo është arsyeja pse ne të gjithë meritojmë të dimë kush na ka hequr nga Facebook-u i tyre. Ndonjëherë njerëzit kanë një arsye të mirë për t'iu bllokuar dhe sigurisht duhet ta respektoni atë, por kjo nuk do të thotë që nuk meritoni të dini kush

janë ata që ju kanë bllokuar. Së pari, thjesht klikoni emrin e personit që mendoni se iu ka bllokuar. Nëse nuk iu del, ose mund t'iu kenë bllokuar ose kanë çaktivizuar llogarinë e tyre. Nëse keni një bisedë të vjetër me këta persona, klikoni mbi të. Nëse emri i tyre shfaqet me shkronja të zeza dhe nuk mund të klikoni mbi të, ata me shumë mundësi janë ende përdorues aktiv

dhe ju kanë bllokuar. Ende nuk mund ta besoni që dikush pati guximin t'ju largonte nga jeta e tyre virtuale? Nuk jeni plotësisht të bindur për këtë gjë? Atëherë kërkoni ndihmë nga një mik në jetën reale. Kërkojini mikut tuaj të kontrollojnë nëse profili i personit që ju mendoni se iu ka bllokuar është aktiv. Nëse po, atëherë dyshimet tuaja janë të konfirmuara.





AFRIKA E JUGUT,

vendi i aventurave më ekstreme

Afrika e Jugut është vendi i peizazheve të lë pa frymë, shtrirje të gjelbra që ndryshojnë me vargjet malore, ngjyrat magjepsëse, plazhet e bukura dhe safaristët. Por është gjithashtu vendi ideal për ata që dëshirojnë të kalojnë kohë duke iu përkushtuar aventurave më ekstreme. Kombi afrikan në fakt është rizgjedhur kohët e fundit si destinacioni më i lartë i aventurave për 2018-ën nga rrjeti ndërkombëtar i turizmit "TYRatism", ndërkohë që Afrika e Jugut ofron aktivitete të shumta adrenaline.



MACJA, "NXËNËSE"

e rregullt e shkollës së mesme në Izmir

Mësuesja ka vënë re se disa nxënës filluan të vinin më herët në shkollë, vetëm të kalojnë pak kohë me Tombin

Duke marrë në konsideratë metoda të pazakonta të mësimdhënies, mësuesja Ozlem Pinar Ivasci, nga shkolla fillore në Izmir të Turqisë, ka vendosur që të lejojë praninë e maces Tombi në klasë dhe në këtë mënyrë të rrisë interesimin e fëmijëve për shkollën, shkruan Anadolu Agency (AA).

Macja, të cilën në fillim fëmijët e ushqenin në oborrin e shkollës, duke u përshtatur me ta, filloi të shkojë edhe në klasë dhe kështu u bë një nga "nxënësit" më të rregullt. Tombi, siç e thërrasin fëmijët, filloi lirshëm të ecë mbi bankat e shkollës. Kur ajo fle, fëmijët përpiqen të jenë sa më të heshtur dhe të dëgjojnë me kujdes mësimet në mënyrë që të mos e zgjojnë mikun e ri.

Mësuesja ka vënë re se disa nxënës filluan të vinin më herët në shkollë, vetëm të kalojnë pak kohë me Tombin. Ivasci vendosi të marrë leje nga administrata e shkollës që të pranojë Tombin në klasë. Janë bërë të gjitha vaksinat e nevojshme, ndërsa i është nxjerrë edhe pasaportë. Megjithatë, njëri nga prindërit ishte i shqetësuar për higjienën në klasë, prandaj macja është larguar. Derën e shtëpisë ia hapi mësuesja Ivasci, por ajo nuk u përshtat me kafshët e tjera në shtëpi.

Për kthimin e Tombit në klasë u përfshinë edhe autoritetet, dhe macja tani përsëri "ndjek" mësimet. Mësuesja Ivasci për AA tha se Tombi dallon nga nëntë macet e tjera që fëmijët ushqejnë në oborr.

"Nxënësit janë bërë më të kujdesshëm që kur Tombi u kthye. Më parë ata vraponin nëpër klasë dhe bënin rrëmujë, por që kur erdhi macja, fëmijët përpiqen që të mos e zgjojnë duke mos vrapuar dhe duke mos e ngritur zërin për ta shqetësuar", shpjegon Ivasci. Nxënësja Tuana Tuntar, tha se ishte e lumtur për kthimin e maces Tombi në klasë.

"Macja çdo mëngjes shëtit mes bankave dhe na përshëndet. E përshëndes edhe unë atë, dhe ajo vjen të fle tek unë. Ne do t'ia bëjmë një shtëpi në oborrin e shkollës, për të qenë e sigurt", tha Tuntar. Selen Bekdemi tha se ishin shumë të pikëlluar kur Tombi ishte detyruar të largohej.

"Jemi shumë të lumtur për kthimin e saj dhe më nuk jemi të pikëlluar. Kur fle, nuk duam ta zgjojmë", shtoi ajo. Nxënësi Emir Bayram tha se me Tombin për herë të parë u takua në oborrin e shkollës. "Falë Tombit, paqja erdhi në klasë. Macja është shumë e ëmbël dhe ka 4 muaj gjysëm. Asaj i pëlqen të qëndrojë tek Tuana. Nuk na shkakton ndonjë dëm. Jemi të lumtur që u kthye", tha ai.





DASHI 21. mars - 20. prill

Për shkak të kontradiktave të shumta mes planetëve, jeta juaj në çift nuk do jete aq e mire sot. Debatet nuk do kenë të mbaruar edhe për shkak të kokëfortësisë së të dyve. Beqaret do kërkojnë shumë, por nuk do arrijnë të bëjnë për vete askënd. Fatmirësisht perspektivat financiare do jene të mira. Mund të kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër pa pasur frike.



DEMI 21. prill - 21. maj

Priten probleme të shumta në jetën tuaj në çift gjatë kësaj dite. Ai që keni në krah nuk do iu dëgjojë se çfarë do thoni dhe do veprime sipas mendjes së tij. Beqaret, fale mbështetjes që do iu japin yjet, do mund të gjejnë personin e tyre të ëndrrave dhe të hedhin hapat e para drejt një lidhjeje. Në planin financiar mund të përballeni me disa të papritura. Kujdes!



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Personi që keni në krah do mundohet shumë që t'ua plotësojë të gjitha dëshirat sot në mënyrë që edhe ju të ndiheni sa me mire. Dita do jete me e bukur dhe plot ngjyra. Beqaret do i dëgjojnë shumë ato që do iu thonë disa të afërm dhe nuk do hedhin asnjë hap pa qene të sigurte. Sektori i financave do jete mjaft i privilegjuar. Do ketë përmirësime të ndjeshme sot.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Nuk do ndiheni shumë rehat pranë partnerit tuaj sot dhe here pas here do vini në pikëpyetje vazhdimësinë e bashku. E mira do ishte të flisnit hapur me të. Beqaret nuk duhet t'iu besojnë të gjithë atyre që do iu propozojnë, por të tregohen me të matur. Në planin financiar nuk është momenti të kryeni investime të mëdha sepse mund të rrezikoni shumë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite mjaft animuar kjo e sotmja për të gjithë të dashuruarit. Do jeni tolerante dhe nuk do iu mungojë për asnjë moment komunikimi. Do bashkëpunoni gjithë kohës me partnerin. Jupiteri do jete si thike me dy presa për beqaret. Vërtet do keni takime, por personat nuk do jene ashtu si duken. Kujdes! Në planin financiar do favorizohen transaksionet e mëdha.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Sot do iu duhet të bëni disa zgjedhje shumë të rëndësishme që do ndikojnë në tëpërmi tek e ardhja juaj. Flisni sa me shumë dhe bini dakord me atë që keni në krah. Beqaret do e kenë serish të vështirë ta gjejnë atë që duan kështu që do mbeten serish vetëm. Financat nuk do jene në gjendjen me të mire, madje po shpenzuar shumë do keni probleme serioze.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do dashuronit ashtu si e ndjeni sot pa menduar fare se çfarë thonë të tjerët. Do bëni shumë mire, madje këtë duhet ta kishit bere me kohe. Beqaret me shumë gjase do kenë takimin që kane pritur prej kohësh dhe do ndihen për mrekulli. Në planin financiar duhet të merreni me tepër me menaxhimin e të ardhurave dhe të shmangni për disa kohe investimet e tejskajshme.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Urani do ndikojë negativisht në jetën tuaj në çift sot dhe asgjë nuk do shkoje ashtu si ata e kishin menduar. Mundohuni ta përmbani veten në disa situata sepse gjërat mund të marrin tatëpjetën. Beqaret do bëjnë çmos që ta gjejnë personin e duhur dhe do ia arrijnë qëllimit. Në planin financiar yjet do iu ndihmojnë ta stabilizoni situatën. Do jeni me të qete.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do keni kontradikta të shumta me partnerin tuaj sot dhe asgjë nuk do shkoje ashtu si e keni dashur. Me mire qëndroni pak larg personit që doni dhe mendoni seriozisht çfarë do bëni. Fale Uranit, beqaret mund të kenë një takim interesant me një person mjaft simpatik dhe serioz. Venusi do i mbroje financat tuaja gjithë kohës dhe nuk do keni asnjë të papritur.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Harmonia do mbizotërojë sot gjatë gjithë kohës dhe ju do ndiheni për mrekulli pranë atij që dashuronit. Disa do bëjnë edhe plane për një fejsje të mundshme. Ata që janë vete do kenë disa takime interesante, por asnjëra nuk do shndërrohet në një dashuri të madhe. Në planin financiar do përballeni me situata jo të këndshme. Nuk do i kryeni dot shpenzimet që kishit menduar.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ata që janë në një lidhje do jene me të predispozuar të tolerojnë dhe të tregohen të kuptueshëm. Priten takime shumë të rëndësishme gjatë kësaj dite për të gjithë ata që janë vetëm. Bëjini sytë katër nëse doni që jeta juaj të ketë me tepër ngjyra. Financat do kenë goxha përmirësime. Filloni duke shlyer borxhet që keni pasur e me pas kryeni ndonjë shpenzim të nevojshëm.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Jo vetëm që marrëdhënia juaj në çift do jete e mire, por shpesh do kaloni në delir. Çdo gjë do iu duket një ëndërr e bukur nga e cila nuk do preferoni të zgjidheni shpejt. Beqaret do njihen me një person pas të cilit do fiksohen keq. Zemra juaj do rrahe që me shikim të pare. Në planin financiar do arrini të ruani një ekuilibër të mire dhe nuk do keni vështirësi.



NE KETE DITE

THEMELUESIT, TË PARËT E NJË ORGANIZATE	P	FILM I KINEMATOGRAFIT NË FOTO	FILM I KINEMATOGRAFIT NË FOTO	KAFSHË E EGËR GJITARE
NOKFA E IBRAHIMOVIQIT				
TABELA E OREVE				
POETI TETOVAR, ARIFI				
I ERRËTI				
EMRI I VJETER I TOKIOS				SISTEM QEVERISJEJE MBRETERORE, ABSOLUTIZMI
TRAJTA QË MERR EMRI GJATE LAKIMIT				
Ë		TONIN ULDEDAJ		
SHOQËRIA AKSIONARE		ZË ME DORË DIÇKA		
MBIEMRI DHE EMRI I KITARISTIT TË NUJHUR SPANJOLL				
PJESË E DRAMËS (SH. PASHQ.)				
LITUMI				
SOPRANOJA JONË, ALIAJ				
KOBALTI				
SHUMËSI BANORI I TAKES				
SHTRESË KAFSHË UJI				
D				
VOZITËS I AEROPLANIT				
				QË I PËRKET EPIKËS LETËR E PALOSUR PËR TË FORMUAR 4 FAQE
IMPULSI		FOSFORI EMËRTIM PËR KALIN E ZI	FRYMË E NGROHTË QË DEL NGA GOJA; AVULL	AR (FRENGJ.) PROVINCË NË PERU
KINEMATOGRAFI I NUJHUR SHQIPTAR NË FOTO				
QË KATË BËJË ME GJOKSIN (MJEK)				
T				HEROI YNË, SOKOLI NOMEN NESCIA
AUTORI ANGLEZ, BRAUN (KODI I DA VINÇIT)			ENË BAKRI SQUFURI	INTENSITETI TEMPERATURA
FILM I KINEMATOGRAFIT NË FOTO				

ZGJIDHJET: P, IBRA, ORAR, NADI, I ZIU, EDO, RASA, E, TU, SH, KAT, DE LUCIA PACO, PILOT, EPIK, I, P, AFSH, OR, SAIM KOKONA, TORAKAL, MIC, DAN, SINI, I, APASIONATA.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

				6						3	9			2	1	6	
1		8	7		3		4			8		4				2	
	2	4			3	1	5				7			6	3		
	7				1				6		2			3			8
8				6				9						5			
			8				7			9				6		2	7
	1	7			8	9	6				3	1				5	
2		6		4		5		3		4				8			1
					2					6	1	3			8		7

Shumë i lehtë: 935416728, 168275394, 724983156, 679321845, 851764239, 342859671, 417538962, 296147583, 583692417. Mesatar: 539782164, 186493725, 427516398, 652937481, 718254639, 394861257, 873129546, 245678913, 961345872.

Në Krefeld të Gjermanisë do të ndërtohet xhamia me minare 38 metërshe



Vitin e ardhshëm në qytetin gjerman Krefeld do të fillojë ndërtimi i një xhamie, minarja e së cilës do të jetë e gjatë 38 metra. Autoritetet gjermane në dhjetor të vitit të kaluar dhanë lejen e nevojshme të

ndërtimit, ndërkohë që sipas koordinatorit të punimeve për ndërtimin e saj, Erdinc Sezer, lokacioni i xhamisë do të jetë në qendër të qytetit. Në një prononcim për AA, Sezer tha se xhamia do të jetë e gjatë

26 metra, minarja 38, ndërsa kupola 19 metra, me një sipërfaqe të oborrit prej 1.100 metra katrorë. "Në nëntor të vitit 2016 dorëzuam një kërkesë për ndërtimin e xhamisë. Lejen e morëm në dhjetor të vitit të kaluar, ndërsa bëhet fjalë për një xhami e cila do të mund të pranojë rreth 560 persona", tha Sezer. Ai theksoi se në kuadër të xhamisë do të ketë edhe objekte shoqëruese. "Në kuadër të xhamisë do të ketë një sallë takimesh me rreth 340 metra katrorë, tetë dhoma, librari dhe leximore. Xhamia do të jetë dy minuta nga qendra e qytetit, me një parking për 51 automjete", tha Sezer, duke informuar se punimet do të fillojnë nga mesi i vitit 2019. Xhamia "Fatih" do të ndërtohet nën sponsorizim të Unionit turko-musliman për çështje fetare, DITIB. Krefeldi është një qytet me rreth 225 mijë banorë dhe ndodhet në krahinën federale Rajna-Vestfalia Veriore.

EKSPERTËT: Seksi ndihmon për dhimbjen e kokës



Studiuesit kanë hedhur poshtë mitin se seksi të shton dhimbjen e kokës. Harrojeni tashmë këtë teori. Sipas ekspertëve, seksi ju ndihmon për të larguar dhimbjen e kokës. Një ekip neurologësh i Universitetit të Munster në Gjermani zbuloi se më shumë se gjysma e personave që morën pjesë në studim dhe që kishin dhimbje koke, patën përmirësim pasi kryen marrëdhënie seksuale. Surprizues ishte edhe fakti që 1 në 5 personave iu largua dhimbja e kokës, veçanërisht tek meshkujt. Studiuesit argumentojnë se seksi nxit çlirimin e endorfineve nëpërmjet sistemit nervor qendror, gjë që mund të zvogëlojë ose eliminojë dhimbjen e kokës. Një tjetër mit i hedhur poshtë nga studiuesit është edhe teoria se marrëdhëniet seksuale rrisin shanset për atak në zemër. Në studim u morën 536 pacientë që vuanin nga zemra të grupmoshave 30-70 vjeç. Në përfundim të studimit u arrit në konkluzionin se aktiviteti seksual nuk është faktor rreziku për sulmet në zemër.



Avioni më i madh komercial në botë u soll në Doha

Avioni më i madh dhe më i fuqishëm komercial Airbus A350-1000 u soll në Doha dhe i është dorëzuar kompanisë Qatar Airways. Qatar Airways do të jetë aviokompania e parë e cila do të shfrytëzojë versionin më të ri të gjigandit të Airbus-it, ndërsa kreu i kompanisë katarase, Akbar al-Bakir, në solemnitetin në aeroportin në Doha tha se ky është një hap historik në aviopërdorimin. Bakir paralajmëroi se Qatar Airways

pret dorëzimin edhe të një avioni A350-1000 dhe të paktën tre muajt e ardhshëm do të jetë e vetmja kompani që në inventarin e saj ka avionin më të madh të pasagjerëve në botë. "Pesë vitet e ardhshme planifikojmë të blejmë 41 avionë të rinj ndërsa në rast nevojë ky numër mund të rritet në 50", tha Bakir. Avioni më i madh në botë do të përdoret në linjën e Qatar Airways nga Doha drejt Londrës.

Në Arabinë Saudite do të mbahet shfaqja e parë publike e modës



Në qytetin lindor të Arabisë Saudite Xhida do të organizohet shfaqja e parë e modës për gra në këtë vend. Evenimenti organizohet si pjesë e edicionit të 19-të të Shfaqjes Ndërkombëtare Saudite të Dasmave, që sponsorizohet nga Princesha Moudi bint Nasser Al Saud, njofton e përditshmja saudite Okaz. "Gratë saudite dëshirojnë të pu-

nojnë lirshëm në vendin e tyre", tha modelisti saudit Ghadir Afghani. "Në të kaluarën, shfaqjet e modës nuk mbaheshin në publik. Por kjo nuk do të ndodh më", tha Afghani. "Bota e modës furnizon thelbësisht gratë, gjë që na nxiti të mbanim evenimentet tona të mëparshme jashtë Arabisë Saudite. Por tani, ne jemi duke planifikuar aktivisht evenimentet brenda mbretërisë", shtoi modelisti, i cili ka marrë pjesë në shfaqje të shumta të modës jashtë shtetit. Sipas drejtorit të evenimentit, Darine Kabbouch, tregu saudit i dasmave është një nga më të pasurit në botë, në të cilën sauditet e pasur paguajnë shuma të mëdha për ceremonitë dhe ahengjet e dasmave. Në shfaqjen treditore në Xhida do të marrin pjesë 160 kompani vendase dhe ndërkombëtare të specializuara në modë, kozmetikë dhe bizhuteri.

1815 - Napoleoni dhe 1200 persona largohen nga Elba për të filluar ripushtimin 100 ditor të Francës.

1848 - Marksi dhe Engelsi botojnë "Manifestin Komunist".

1885 - Kongresi i Berlinit, jep Kongon Belgjikës dhe Nigerinë Anglisë.

1924 - Fillon gjykimi kundër Hitlerit në Munih.

1925 - Xhihad - Luftë e shenjtë kundër qeverisë turke.

1960 - Kryeministri sovjetik Kruščev përkrah Indonezinë.

1980 - Egjipti dhe Izraeli këmbëjnë ambasadorët për herë të parë.

2001 - Talibanët shkatërrojnë dy statuja të mëdha të Budës në Bamyani të Afganistanit.

2004 - Vdes tragjikisht në aksident ajror presidenti i Maqedonisë .Boris Trajkovski afër Mostarit në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Është vërtetuar që një ari i rritur mund të vrapojë po aq shpejt sa një kalë. Kurse breshka mund të ecë me 10 km në orë.



Syri i një struci është më madh se truri i tij, ndërkohë që në trurin e macëve ka më shumë se 32 muskuj.



Krokodili është e vetmja kafshë që vazhdon e zgjatet deri në ditën e fundit të ekzistencës, centimetrat e saj ndryshojnë nga muaji në muaj.



POLICI DHE MOLLËT

Për çka nevojiten këto farë molle, pyet polici tregtarin.
-Këto të japin mend, i thotë ai.
-Po sa kushtojnë këto?
-Tri kokrra, 2 euro i thotë ai.
Polici i bleu, i hëngri dhe i'u kthye tregtarit:
-Ti më mashtrove, me dy euro i kisha blerë tre kg mollë.
-Eeee, a e sheh sa të mira ishin mollët që t'i dhashë, a u mbushe me mend?



Detyra jote nuk është të kërkosh për dashurinë, por thjeshtë të kërkosh dhe të gish të gjithë pengesat brenda vetes tënde, që ti ke ndërtuar kundër saj. **(Rumi)**



KALENDARI HISTORIK 26 SHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS